

# RAPORTI VJETOR

I VEPRIMTARISË MËSIMORE, KËRKIMORE-SHKENCORE  
DHE FINANCIARE PËR VITIN 2023-2024

---



# Përmbajtja

I. HYRJE .....	4
II. PËRMBLEDHJE .....	5
III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UMT .....	9
3.1 Organizimi i UMT-së .....	9
3.2 Funksionimi i organeve kolegjiale/drejtuese.....	10
3.3 Zgjedhjet për autoritet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme.....	13
3.4 Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad- hoc .....	13
3.5 Aktiviteti i njësive kryesore .....	13
3.5.1 Fakulteti i Mjekësisë .....	13
3.5.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare .....	18
3.5.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike .....	21
3.5 Sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore .....	24
IV. VEPRIMTARIA AKADEMIKE.....	25
4.1 Programet e studimit .....	25
4.2 Procesi mësimor, mësimdhënia, vlerësimi dhe pranimet.....	26
4.3 Kodifikimi i programeve të studimit .....	27
V. SIGURIMI I CILËSISË.....	29
VI. PERSONELI AKADEMIK .....	31
6.1 Personeli akademik .....	31
VII. KËRKIMI SHKENCOR.....	33
7.1 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti .....	34
7.2 Projekte.....	37
7.3 Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+ .....	52
7.4 Anëtarësimi i UMT-së në rrjete ndërkombëtare .....	53
7.5 Aktivitete të edukimit të vazhdim .....	53
VIII. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK.....	55
8.1 Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet .....	55
IX. STUDENTËT.....	58
9.1 Regjistrimet në programet e studimit për vitin akademik 2023-2024 .....	58
9.2 Mbështetja ndaj studentëve .....	59
9.3 Aktivitetet sportive në UMT .....	60
X. ANALIZA FINANCIARE 2024 .....	61
XI. REFERENCA .....	62
<b>Aneksi nr. 1_Lista e programeve të studimit të ofruara në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë .....</b>	<b>63</b>
Foto galeri “Aktivitete te UMT-sw pwr informim 2023-2024” .....	66
Foto galeri “Aktivitete 2023-2024_Fakulteti i Mjekësisë” .....	80

Foto galeri “Aktivitete 2023-2024_Fakulteti i Mjekësisë Dentare” .....	87
Foto galeri” Aktivitete sportive 2023-2024_UMT” .....	90

# I. HYRJE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Planin e zhvillimit strategjik të UMT- së, si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore për vitin akademik 2023-2024 dhe financiar për vitin kalendarik 2024 në nivel universiteti, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij.

Misioni i Universiteti të Mjekësisë, Tiranë është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron programe në tri ciklet e studimit, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha.

Në zbatim të misionit të universitetit dhe kuadrit ligjor në fuqi, ky raport synon të paraqesë aspektet kryesore të aktivitetit akademik në UMT, duke vënë theksin edhe te problematika të evidentuara dhe të adresuara për zgjidhje, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë.

Ky raport bazohet në raportet analitike të njësive kryesore (fakultetet) të UMT-së, si dhe të strukturave të tjera të UMT-së, konkretisht, ky raport është bazuar në:

- Raportin Vjetor të Fakultetit të Mjekësisë përcjellë me shkresë nr. 3917/1 prot., datë 06.12.2024 “Përcillet raporti vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare...”;
- Raportin Vjetor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare përcjellë me shkresë nr. 707/5 prot., datë 05.12.2024 “Dërgohet raporti vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare...”;
- Raportin Vjetor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike përcjellë me shkresë nr. 1711/7 prot., datë 06.12.2024 “Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare...”;
- Raporte informuese e analitike të organeve kolegjiale të UMT-së;
- Raporte informuese e analitike të komisioneve në nivel universiteti (Këshilli i Botimeve, Këshilli i Etikës, Komisioni i Promovimit të Titujve Akademikë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë);
- Raporte informuese analitike të njësive përbërëse të Rektoratit të UMT-së, lidhur me aspektet ligjore, kurrikulën, pranime dhe sigurimin e cilësisë, projektet dhe programet e kërkimit shkencore etj.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të universitetit, i cili publikohet pas miratimit në organet kolegjiale, ndërsa aktivitetet e detajuara në nivel njësie kryesore gjenden në raportet vjetore përkatëse të cilat janë publikuar në faqet zyrtare të fakulteteve.

## II. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik 2023-2024 dhe financiar për vitin kalendarik 2024, të zhvilluar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Raporti vjetor paraqet informacione, gjetje, konstatime dhe vlerësime për të gjitha aspektet e veprimtarisë që universiteti dhe fakultetet e tij zhvillojnë.

Raporti pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për:

- funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UMT-së dhe të fakulteteve;
- procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore;
- kërkimin shkencor, projektet dhe programet kombëtare dhe ndërkombëtare të UMT, ku personeli akademik, studentët e UMT, si dhe personeli joakademik (në programe shkëmbimi) marrin pjesë si palë aktive. Raporti adreson aspekte të politikave të kërkimit shkencor, të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga departamentet, si dhe të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor;
- programet e studimit që ofron UMT-ja, duke paraqitur programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, riorganizimin e tyre në kuadër të përditësimit, hapjen e programeve të reja si dhe ofrimin e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetit;
- angazhimin e personelit akademik dhe ngarkesën mësimore;
- gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet në UMT;
- numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UMT-ja, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtare, ndërkombëtar si dhe mbështetjen për mobilitetin e tyre në kuadër të projekteve Erasmus, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;
- mobilitetin e personelit akademik të financuar nga fakulteti/UMT-ja apo të realizuar në kuadër të projekteve/programeve;
- infrastrukturën, ku përfshihen mjediset didaktike dhe kërkimore, politike në shpërndarjen e fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numrin e teksteve dhe infrastrukturën informatike në funksion të mësimin, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë;
- plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukurore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin;
- zgjedhjet për autoritet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë kryesore të UMT-së, nga sektorët përkatës të Rektoratit, nga sekretariatet teknike të organeve kolegjiale, si dhe në bazë të raporteve dhe analizave të kryera nga UMT për institucione të tjera, rezulton se:

**Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, organizohet dhe menaxhohet në zbatim të Statutit dhe Rregullores së tij. Organet kolegjiale dhe drejtuese të UMT-së funksionojnë bazuar në rregullore specifike e procedura, të miratuara sipas ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, Statutit të UMT -së, si dhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Nga burimet në dispozicion të UMT, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Universiteti është në gjendje të tërheqë një gamë të gjerë burimesh dhe mbështetje nga sektori i shëndetësisë dhe të përfitojë, në veçanti, nga afërsia fizike me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe strukturat e tjera spitalore universitare. Kjo ofron një shtrirje burimesh të vazhdueshme dhe të pasura, si për stafin, ashtu edhe për studentët.

Mekanizmat financiare të UMT-së për të siguruar të ardhura nga shërbime cilësore për të tretë që mund të ofrojë universiteti, me kapacitetet akademike, profesionale dhe infrastrukturore që ka (edukimi në vazhdim, ofrim shërbimi ndaj pacientëve etj.), ende nuk janë të institucionalizuara.

**Kurrikula** që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profesionit dhe mbështetet nga një rrjet i fuqishëm profesionistësh të shëndetësisë dhe urdhrash profesional. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara, kjo në përmbushje të misionit që UMT ka “*...ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron programe në tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha*”.

Planet mësimore janë objekt rishikimi periodik nga njësitë kryesore/bazë të UMT-së, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Për vitin akademik 2023-2024, Senati Akademik i UMT ka konfirmuar në total 29 plane mësimore (pa ndryshime), si dhe ka miratuar ndryshimin (përmirësimin i cili nuk e ka tejkaluar masën 20%) vetëm në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, ku janë shtuar orët e praktikës klinike për studentët e vitit VI.

Gjithashtu, UMT ka finalizuar me sukses hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit Master Ekzekutiv në “Kirurgji Pediatrike”, ofruar nga Fakulteti i Mjekësisë, me Urdhër nr. 321, datë 27.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

**Pranimet** e kandidatëve në programet e studimit që ofron UMT, kryhen në zbatim të ligjit nr.80/2015 “*Për arsimin e lartë...*”, Statutit dhe Rregullores së UMT, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe në përputhje me kuotat dhe kriteret e pranimit të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së.

Risi për vitin akademik 2023-2024, ishte futja e testimit të informatizuar në grup lëndët biologji, kimi dhe fizikë, si kriter pranimi për kandidatët në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Mjekësi e përgjithshme”, përpos rezultateve të arsimit të mesëm dhe maturës shtetërore. **Testimi i informatizuar** u zhvillua në QSHA, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe UMT “Për testimin e informatizuar...”, si dhe Urdhrit nr.183, datë 01.11.2022 “Për miratimin e rregullores për procedurat...” të MAS.

**Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi** në UMT, kryhet në përputhje me Statutin, Rregulloren e universitetit dhe rregulloret e njësive kryesore të tij. Në vitin akademik 2023-2024 procesi mësimor në UMT u zhvillua në përputhje me planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Sigurimi i Cilësisë** në UMT është një proces i vazhdueshëm në kuadër të përmirësimit të kurrikulave, metodave të mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit, promovimit dhe kualifikimit të mëtejshëm të personelit akademik, administrativ dhe mbështetës.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, të gjitha programet e ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (19 programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë) janë nënshtruar procesit të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm, në kuadër të akreditimit të tyre. Ky proces pritet të finalizohet me vendimet e Bordit të Akreditimit.

**Studentët** janë të përfaqësuar në organet kolegjiale të UMT sipas përcaktimve në statutin e UMT (Senat akademik, NJSBC etj). Ata vetëorganizohen në këshilla studentorë. Këto këshilla funksionojnë në bazë të akteve rregullative të miratuara prej tyre. Ata planifikojnë aktivitete në fushën e mjekësisë (ditët botërore të shëndetit) apo kulturore sociale sipas një plani vjetor. Veprimtaria e Këshillave Studentorë mbështetet nga njësitë kryesore dhe universitetit me logjistikë infrastrukturore apo materiale.

Në njësitë kryesore të UMT-së funksionojnë Zyrat e Karrierës në mbështetje të studentëve në lidhje me tregun e punës, duke siguruar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial; në zhvillimin e aktiviteteve të përvitshme për të afruar studentët në prag të diplomimit me punëdhënësit e mundshëm (panaire pune etj); në ofrimin e këshillimit dhe udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve. Zyra e karrierës (ZK) bashkëpunon ngushtë me departamentet për mundësitë e akomodimit të studentëve në institucione/kompani/organizata në funksion të praktikave profesionale të studentëve; informon studentët e ardhshëm nëpërmjet aktiviteteve periodike që organizon fakulteti/universiteti për këtë qëllim. ZK mbështet, inkurajon dhe asiston jetën kulturore, artistike dhe sportive të studentëve.

Gjithashtu, në rëndësi të vecantë i është kushtuar aktivizimit të studentëve dhe pjesëmarrja e tyre në aktivitete sportive të cilat organizohen në rang universiteti/lokal apo dhe nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar. Ngritja e ekipeve sportive me studentë sipas disiplinave dhe veprimtaritë sportive, ndiqen nga specialisti përgjegjës për sportin në Rektorat, i cili bashkëpunon ngushtë me shoqatën sportive të UMT, si dhe me strukturat e tjera të njësive kryesore. Gjatë vitit 2023-2024, ekipet sportive të UMT kanë treguar aftësitë e tyre të shkëlqyera në disiplinat basketboll, volejball, futsall, ping pong, etj., si dhe kanë arritur të sigurojnë fitore në disa kampionate ndëruniversitare.

Në kuadër të vlerësimit të performancës së alumni-t, UMT mbledh dhe analizon të dhënat zyrtare për punësimin e tyre, nga Urdhrat përkatës për profesionet e rregulluara, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe nga zyrat e karrierës në nivel Fakulteti.

Raporti i detajuar sipas aspekteve të ndryshme akademike që trajtohen, është përshtatur dhe përmbledhur nga Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera pranë Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, ndërkohë që përmbledhja dhe përshtatja e analizës financiare (kreu X) është përgatitur nga Drejtoritë përgjegjëse për financat në Rektoratin e UMT-së.

# III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UMT

## 3.1 Organizimi i UMT-së

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë<sup>1</sup>, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)”, i ndryshuar. Pas riorganizimit në vitin 2016, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë aktualisht përbëhet nga 3 (tri) njësi kryesore (fakultete) si më poshtë:

1. Fakulteti i Mjekësisë
2. Fakulteti i Mjekësisë Dentare
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, struktura akademike dhe administrative e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është e organizuar si më poshtë:

- Organe kolegjiale në nivel universiteti: *Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i Përhershëm i Promovimit Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Botimeve, Komisioni Institucional Zgjedhor, NJSBC;*
- Autoritetet drejtuese: *Rektori, Dekanët e njësive kryesore, Përgjegjësit e njësive bazë, Administratori dhe Administratorët e njësive kryesore;*
- Organet drejtuese: *Rektorati, Dekanatet, Departamentet;*
- Njësitë kryesore: *Fakulteti i Mjekësisë, me 16 njësi bazë; Fakulteti i Mjekësisë Dentare, me 3 njësi bazë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me 3 njësi bazë;*
- Personeli akademik dhe personel ndihmës akademik.
- Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ dhe struktura administrative në Rektoratin e UMT-së dhe e fakulteteve të UMT-së.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, e ushtron veprimtarinë e tij, kryesisht bazuar në:

- Legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor (ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”), Vendimet e Këshillit të Ministrave, Urdhra dhe Udhëzime të ministrit përgjegjës për arsimin, Kodin e Cilësisë për Arsimin e Lartë, si dhe akte të tjera të miratuara e që zbatohen në arsimin e lartë);
- Statutin e UMT-së (*miratuar me Urdhër nr. 424, datë 8.8.2019 të ministrit përgjegjës për arsimin*),
- Akte rregullative<sup>2</sup> të UMT-së;
- Vendime të organeve kolegjiale në UMT;
- Udhëzime dhe Urdhra të autoriteteve drejtuese.

---

<sup>1</sup> Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka fillimin e tij që me krijimin e Fakulteti i Mjekësisë në vitin 1957, si vazhdim i Institutit të Lartë Mjekësor (hapur për herë të parë si institucion i arsimit të lartë në Shqipëri në shtator të vitit 1952), i cili kishte për mision përgatitjen e mjekëve të përgjithshëm. Fakulteti i Mjekësisë në 2013 u riorganizua në 4 (katër) fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Farmacisë, Fakulteti i Shëndetit Publik dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

### 3.2 Funkionimi i organeve kolegjiale/drejtuese

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit dhe të Rregullores të UMT, çdo njësi/strukturë, personel akademik, ndihmës akademik dhe jo akademik është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon universiteti për realizimin e objektivave për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë janë të ngritura Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik (KPPPA), për dhënien e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” dhe Komisionet e Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të UMT-së.

Referuar aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit akademik, organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese kanë kryer veprimtaritë kryesore si vijon:

**Senati Akademik** kryen veprimtarinë e tij në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit dhe të Rregullores të UMT-së, si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Konkretisht Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij në mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë vitit 2024, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse. Senati akademik për ushtrimin e detyrave të tij funksionale, ka marrë 145 (njëqind e dyzet e pesë) vendime<sup>3</sup>.

Konkretisht, tematika e këtyre vendimeve është si më poshtë:

1. Vendime të karakterit akademik, mësimor e shkencor (*miratim i kriterëve të pranimit në programet e studimit; miratim i kuotave të pranimit për programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë; rishpërndarje e kuotave të pranimit në programet e specializimeve afatgjata; miratim i programeve të reja të studimit; miratim për ndryshimin e planeve mësimore në masën nën 20%; miratimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në UMT; miratimi i kandidatëve të kategorisë profesor etj*).
2. Vendime të karakterit financiar (*miratim i tarifave të shkollimit të të tre cikleve të studimit; miratim të tarifës së aplikimit për programet Doktoratë; miratim të tarifës së shërbimit për fitimin e titujve akademikë; miratim të kostos së plotë të studimeve të PIND “Mjekësi e Përgjithshme; miratim i trajtimit financiar të Këshillit të Etikës dhe të Botimeve; miratimi i nivelit të pagave për personelin akademik të UMT-së etj*);
3. Vendime të karakterit rregullativ (*miratim për një ndryshim në Rregulloren e UMT-së; miratim i ndryshimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata; miratim për një ndryshim në rregulloren për fitimin e titujve akademikë në UMT; miratim në parim i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UMT-së e IAL-së vendase apo të huaja, si dhe me organizata të tjera etj*).
4. Vendime të karakterit administrativ (*miratimi i përbërjes së Këshillit të Botimeve UMT; miratimi i përbërjes së Këshillit të Etikës të UMT-së; miratim për ndryshim në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; miratim i Raportit Vjetor të UMT-së; zgjedhje e antëtarëve të KPPPA-së, etj*.)

---

<sup>3</sup> Informacioni i dhënë nga sekretariati teknik i SA

**Bordi i Administrimit** kryen veprimtarinë e tij në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit dhe të Rregullores të UMT-së, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Konkretisht Bordi i Administrimit, ka ushtruar kompetencat e veta për mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare dhe administrative të UMT-së, nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara. Për vitin 2024 Bordi i Administrimit ka marrë 53 (pesëdhjetë e tre) vendime<sup>4</sup>.

Konkretisht, tematika e këtyre vendimeve është si më poshtë:

1. Vendime të karakterit financiar (shpërndarje Granti, rishpërndarje Granti, miratim të tarifave të shkollimit të tre cikleve, miratim të tarifës së aplikimit për Ciklin e III, Master Ekzekutiv dhe Doktoratë, miratim të tarifës së shërbimit për fitimin e titujve akademikë; miratim të kostos së plotë të studimeve të PIND “Mjekësi e Përgjithshme”, miratim i trajtimit financiar të Këshillit të Etikës dhe të Botimeve);
2. Vendime për trajtimin financiar (bursa apo përjashtim nga tarifat e shkollimit të studentëve);
3. Vendime lidhur me veprimtarinë e NJAB; miratim të planeve të auditimit, të ndryshimeve të tyre, të plotësimit të vakancave, etj.;
4. Vendime të karakterit administrativ si: miratimi Raportit Vjetor të UMT-së, miratimi kritereve dhe dokumentacionit për Administratorët e njëjësive kryesore, etj.

**Rektori/Dekani/Drejtuuesi i departamentit** (autoritete drejtuese) kanë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor, monitorimin e regjistrimit të studentëve, menaxhimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, raportimet periodike, si dhe për zgjidhjen e çështjeve të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit mësimor, sezoneve të provimeve, praktikave profesionale dhe diplomimit. Si autoritete drejtuese, ato kanë zhvilluar takime me titullarë të institucioneve qendrore shtetërore për zgjidhjen e problematikave të hasura në institucion, si dhe kanë përcjellë projekt-propozime konkrete për të gjitha draft-aktet rregullative e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin, në kuadër të mirëfunksionimit të institucionit tonë.

Gjithashtu janë realizuar një sërë takimesh në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me të tretë, takime lobimi për universitetin, si dhe takime informuese me studentët, stafin akademik, median apo të interesuar të tjerë, në kuadër të rritjes së transparencës dhe informimit (disa prej aktiviteteve janë paraqitur edhe në faqen zyrtare të internetit të UMT-së dhe në ato të fakulteteve).

**Rektorati/dekanatet** (organe kolegjiale), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e pranimeve/regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu, janë propozuar dhe miratuar grupe pune të proceseve të organizuara në nivel universiteti, në komisione apo grupe të posaçme.

**Këshilli i Botimeve** (organ kolegjial) në ushtrim të kompetencave të tij, ka fokusuar veprimtarinë e tij në funksion të rritjes së cilësisë të botimeve shkencore në UMT në përputhje me standardet europiane, si dhe është bërë shqyrtimi i manuskripteve të paraqitura për botim nga departamentet dhe fakultetet e ndryshme të UMT-së.

Konkretisht gjatë vitit 2023-2024, Këshilli i Botimeve, në zbatim të procedurave dhe Rregullores specifike për botimet, ka miratuar botimin e 9 teksteve të reja<sup>5</sup> përkatësisht: 2 tekst mësimor; 1

<sup>4</sup> Informacioni i dhënë nga sekretariati teknik i BA

<sup>5</sup> Informacioni i dhënë nga sekretariati teknik i KB

tekst shkencor dhe 6 monografi.

Revista shkencore “Albanian Journal of Medical and Health Sciences” ka vijuar me publikimin me 3 numra në vit dhe konkretisht për vitin 2024 janë publikuar vëllimet:

- Vol. 64, i cili përmban gjithsej 10 publikime, nga të cilat 3 publikime janë nga autorë të huaj dhe 7 nga autorë shqiptarë.
- Vol. 65, i cili përmban gjithsej 10 publikime, nga të cilat 4 publikime janë nga autorë të huaj dhe 6 nga autorë shqiptarë.
- Vol. 66, i cili aktualisht është i publikuar në “Ahead of Print”, përmban 8 publikime, nga të cilat 2 publikime janë nga autorë të huaj dhe 6 nga autorë shqiptarë.

**Këshilli i Etikës** (organ kolegjal) promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës, legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe të tjera akte ligjore e nënligjore në Republikën e Shqipërisë. Këshilli i Etikës siguron që çdo projekt kërkimor të jetë në përputhje me standardet etike të kërkimit shkencor. Gjatë vitit 2024, Këshilli i Etikës ka shqyrtuar afersisht rreth 150 kërkesa për miratim të artikujve shkencorë dhe projekteve kërkimore, dhe janë marrë 45 (dyzet e pesë) vendime<sup>6</sup>, lidhur me etikën në kërkimin shkencor (artikuj/projekte kërkimore), si dhe etikën në procese/veprimtari mësimore të UMT.

**Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** (organ kolegjal), në ushtrim të kompetencave të saj, ka angazhuar anëtarët e saj në nivel fakulteti në komisionet (ad-hoc) përkatëse për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, monitorimin e procesit të regjistrimeve dhe pranimeve, të kalueshmërisë në vit të studentëve aktivë, etj. Gjatë vitit akademik 2023-2024, NjSBC ka mbështetur FSHMT gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për 19 programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe procesit në kuadër të akreditimit të këtyre programeve.

**Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik (KPPA)** është organ kolegjal, përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve në kuadër të fitimit të titujve akademikë në UMT, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet rregullative të UMT në fuqi. Gjatë vitit 2023-2024 UMT ka shqyrtuar në total 69 aplikime për fitimin e titujve akademik Profesor dhe Profesor i Asociuar, nga të cilët 47 tituj akademik “Profesor i asociuar” dhe 22 tituj akademik “Profesor”<sup>7</sup>.

### *Doctor Honoris Causa” në Universitetin e Mjekësisë*

Në vitin akademik 2023-2024, Universiteti i Mjekësisë në Tiranë akordoi dy tituj të nderuar “**Doctor Honoris Causa**”. Njëri prej tyre iu dha **Z. Sergio Caputi**, një figurë e shquar në fushën e stomatologjisë. Ai është nderuar për arritjet e tij shkencore dhe për ndikimin në avancimin e arsimit në fushën e stomatologjisë në Shqipëri, kurse tjetri ju dha **Z. Giovanni Migliore** për “Për kontributin e çmuar në fushën e inovacionit në Menaxhimin e Praktikës Mjekësore në Shqipëri”. Z. Migliore është ai që nisi procesin e binjakëzimit mes QSUT-së dhe Spitalit Publik të Barit dhe ka vlerë të pamohueshme në vijimësinë dhe përmbylljen me efektivitet të këtij procesi.

<sup>6</sup> Informacioni i dhënë nga sekretariati teknik i KE

<sup>7</sup> Informacioni i dhënë nga sekretariati teknik i KPPA

### *3.3 Zgjedhjet për autoritet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme*

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, më 21.06.2024, ka zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme për autoritetet (Rektor, Drejtues i Njësisë Kryesore, Drejtues i Njësisë Bazë) dhe organet drejtuese (Senati Akademik), një proces i suksesshëm dhe transparent votimi, nga i cili u zgjodhën për një mandat 4 (katër) vjeçar, autoritetet e reja dhe anëtarët e Senatit Akademik.

### *3.4 Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad-hoc*

**Rektorati/dekanatet** (si njësi administrative), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar (vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese) dhe kanë nxjerrë akte rregullative lidhur me procesin e pranimeve dhe regjistrimeve në programet e studimit që ofron UMT-ja apo të transferimeve të studimeve, dhënien e përgjigjes dhe të zgjidhjes për kërkesat/ankesat individuale apo në grup drejtuar UMT-së apo fakulteteve etj.

Gjithashtu, lidhur me organizimin e proceseve nga rektorati/dekanati, nëpërmjet komisioneve ad-hoc të ngritura për aspekte të veçanta të veprimtarisë akademike, evidentojmë se:

- Procesi i përlllogaritjes së pikëve të maturantëve dhe rankimit të tyre, në kuadër të pranimeve në programet e studimit në UMT, i kryer nga komisioni i monitorimit dhe grupi teknik (në nivel universiteti), i ngritur për këtë qëllim, është realizuar me sukses.
- Procesi i pranimeve në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, që nga nxjerrja e akteve rregullative, proceset e aplikimit dhe të konkurrimit të studentëve, si dhe përzgjedhjes së programit specializues afatgjatë nga ana e tyre, kryhet dhe monitorohet tërësisht nga Rektorati i UMT-së dhe dekanatet e fakulteteve përkatëse.

### *3.5 Aktiviteti i njësive kryesore*

Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë organizuar në njësi bazë (departamente) sipas profilit të fushave të programeve të studimit që ofrojnë apo profilit të veprimtarisë lëndore, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë që departamentet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre, në funksion të realizimit të procesit akademik e shkencor.

Po ashtu, departamentet dhe personeli akademik përkatës japin një kontribut të rëndësishëm në angazhimet për institucionin. Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik me kohë të plotë kanë qenë pjesë e komisioneve ad-hoc për proceset e pranimeve të studentëve në tre ciklet e studimit.

Në paragrafët e mëposhtëm jepet në mënyrë të përmbledhur aktiviteti i secilit nga fakultetet e UMT-së (informacioni i detajuar gjendet në raportet vjetore për vitin akademik 2023-2024 të secilit fakultet).


### 3.5.1 Fakulteti i Mjekësisë<sup>8</sup>

Fakulteti i Mjekësisë ofron programe studimi të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, me kohë të plotë, përkatësisht:

- Programe të integruara të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë Master i Shkencave në “Mjekësi e përgjithshme”* me kohëzgjatje 6 vite akademike, 360 ECTS, dhe *Diplomë Master i Shkencave në “Farmaci”* me kohëzgjatje 5 vite akademike, 300 ECTS;
- Program i ciklit të parë Bachelor, me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS, në përfundim të të cilit studenti pajiset me *Diplomë Bachelor në “Shëndet Publik”*;
- Programe të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë Master i Shkencave në “Shëndet Publik”* me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 ECTS; *Diplomë Master Profesional në “Shëndet Publik”* dhe *Diplomë Master Profesional në “Menaxhim Shëndetësor”* me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 ECTS;
- Programe të ciklit të tretë, “*Specializime Afatgjata*”, në fushën e Mjekësisë (kohëzgjatja 3-5 vjet). Në vitin akademik 2023-2024, UMT ka miratuar kuotat dhe shpallur thirrjen për aplikim për (studentë të regjistruar në vit të parë) 35 programe të specializimeve afatgjata të ofruara nga ky fakultet.
- Programe të ciklit të tretë “Doktoratë”. Për vitin akademik 2023-2024, Fakulteti i Mjekësisë ka riaktivizuar 13 programe të ciklit të tretë “Doktoratë”, përfshirë programin e përbashkët të doktoratës “*Kirurgji e përgjithshme dhe nënspecialitete*” me Universitetin e Bolonjës, Itali.

Në Fakultetin e Mjekësisë, UMT, për vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar **201** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive:

Personel akademik me kohë të plotë, 2023-2024					
Viti akademik	Profesor		Lektor	As. Lektor	Totali
	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	
2023-2024	83	79	31	8	201



- 41% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 39% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,

<sup>8</sup> Informacioni është marrë nga Raporti Vjetor 2023-2024, Fakulteti i Mjekësisë, UMT

- 16% e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 4% e personelit akademik janë “Lektorë”.

Referuar të dhënave lidhur me kualifikimin e personelit akademik të Fakultetit të Mjekësisë rezulton se 96% prej tyre janë me tituj akademikë dhe grada shkencore.

Fakulteti i Mjekësisë ka specifikën e vet në angazhimin e personelit të strukturave shëndetësore universitare në mbështetje të procesit të mësimdhënies, ku i gjithë personeli i rrjetit spitalor universitar është potencialisht i angazhuar në proceset e mësimdhënies, sipas përcaktimeve në statutin e UMT. Gjithashtu pranë Fakultetit të Mjekësisë janë angazhuar në procesin e mësimdhënies dhe personel akademik me kohë të pjesshme.

Të dhënat për të dy kategoritë e personalit akademik (SSHU dhe me kohe të pjesshme), të angazhuar për vitin akademik 2023-2024, janë si më poshtë:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme dhe SSHU, 2023-2024</i>			
Viti akademik	SSHU	Të jashtëm	Totali
2023-2024	204	61	265




Në total, në Fakultetin e Mjekësisë Tiranë janë angazhuar në procesin e mësimdhënies **466** personel akademik nga të cilët: **405** personel akademik me kohe të plotë UMT+SSHU (**201** me kohë të plotë; **204** staf i SSHU (strukturave shëndetësore universitare)); **61** me kohë të pjesshme, **51** personel ndihmës akademik dhe **27** personel administrativ.

Për vitin akademik 2023-2024, studentët e regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave	SPA	Dr.
Mjekësi e përgjithshme			420		
Farmaci			113		
Shëndet Publik	22	14	15		
Menaxhim shëndetësor		20			
Specializime				221	
Doktoratë					173
<b>Total</b>	<b>22</b>	<b>34</b>	<b>548</b>	<b>221</b>	<b>173</b>
<i>Të regjistruar në FM, viti i parë, gjithsej 998 studentë</i>					

Studentë aktivë (në të gjitha vitet) që kanë ndjekur studimet në FM, viti akademik 2023-2024:

Programi	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave	SPA	Doktoratë
Mjekësi e përgjithshme			2092		
Farmacji			562		
Shëndet Publik	67	14	33		
Menaxhim shëndetësor		20			
Specializime				744	
Doktoratë					173
<b>Total</b>	<b>67</b>	<b>34</b>	<b>2687</b>	<b>744</b>	<b>173</b>
<i>Gjithsej 3705 studentë</i>					



Aktivitetet e edukimit në vazhdim; workshop, seminar, evente (kongrese konferenca); leksione të hapura, trajnime etj janë gjithashtu veprimtari të zhvilluara në FM gjatë vitit akademik 2023-2024. Konkretisht, FM ka ofruar 35 aktivitete tww edukimit në vazhdim të akredituara nga QZHP\_UMT (gjithësej 262.5 kredite).

### 3.5.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare<sup>9</sup>

Fakulteti i Mjekësisë Dentare ofron programe të ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të tretë, të organizuara si më poshtë:

- 1 program i integruar i ciklit të dytë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, 300 ECTS, në përfundim të të cilit studenti pajiset me *Diplomë Master i Shkencave në “Stomatologji”*;
- 2 programe të ciklit të parë “Bachelor”, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë Bachelor në “Higjienë Dentar”* me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS dhe *Diplomë Bachelor në “Teknike Dentare”* me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS;
- 1 program i përbashkët Master Profesional/Master ndërkombëtar i nivelit të parë në *“Higjienë Dentare dhe Terapi Paradontale jo Kirurgjikale”*
- 1 Program i përbashkët Master Ekzekutiv/Master ndërkombëtar i nivelit të dytë në *“Implanto Protetikë”*.
- 4 Programe të ciklit të tretë, *Specializime Afatgjata*, në fushën e Mjekësisë Dentare. Për vitin akademik 2023-2024 janë aktivizuar me kuota pranimi 2 programe specializimi, përkatësisht: *“Terapi Stomatologjike”* dhe *“Pedodonti”*.
- 1 Program të ciklit të tretë Doktoratë në *“Shkenca Mjekësore Dentare”* me 3 (tre) nënfusha i aktivizuar në vitin akademik 2023-2024.


Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë angazhuar **21** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive:

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2023-2024</i>					
<b>Viti akademik</b>	<b>Profesor</b>		<b>Lektor</b>	<b>As. lektor</b>	<b>Totali</b>
	<b>Prof.</b>	<b>Prof. Asc.</b>	<b>Dr.</b>	<b>Master</b>	
<b>2023-2024</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>21</b>

- 19% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 33% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,
- 43% e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 5% e personelit akademik janë “Lektorë”.

Referuar te dhënave të mësipërme rezultone se 95% e personelit akademik të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, janë me tituj akademikë dhe grada shkencore.

**Fakulteti i Mjekësisë Dentare**  
**Personel akademik me kohë të plotë, 2023-2024**



Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FMD-së angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme, personel akademik i brendshëm pwr UMT (te ftuar\* *\_personel akademik i FM-së i cili mbulon lëndë të formimit mjekësor*) dhe personel akademik i huaj, i cili ftohet për të zhvilluar module, cikle leksionesh, numri i të cilëve është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2023-2024</i>				
Viti akademik	Të ftuar*	Të huaj	Me kohë të pjesshme	Totali
	(*nga Fakulteti i Mjekësisë)			
<b>2023-2024</b>	<b>59</b>	<b>31</b>	<b>85</b>	<b>175</b>

Në FMD zhvillojnë veprimtarinë e mësimdhënies **196** anëtarë të personelit akademik: **80 staf i UMT** (21 me kohë të plotë; 59 pedagogë të brendshëm të Fakultetit të Mjekësisë), **116** personel akademik me kohë të pjesshme (85 me kohë të pjesshme, 31 te huaj), si dhe 14 personel ndihmës akademik dhe 7 personel administrativ.


Ngarkesa mësimore e realizuar sipas cikleve të studimit në FMD, për vitin akademik 2023-2024, u realizua e plotë.

Për vitin akademik 2023-2024, studentë të regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi	Bachelor	Master i shkencave	SPA
Stomatologji		134	
Teknikë Dentare	37		
Higjienist Dentar	53		
Specializime			7
<b>Total</b>	<b>90</b>	<b>134</b>	<b>7</b>
<b><i>Të regjistruar në FMD , viti i parë, gjithsej 231 studentë</i></b>			

Studentë që ndjekin aktualisht studimet në të gjitha vitet janë:

Programi	Bachelor	Master i shkencave	SPA	Doktoratë
Stomatologji		545		
Teknikë Dentare	117			
Higjenist Dentar	171			
Specializime			32	
Doktoratë				19
<b>Total</b>	<b>288</b>	<b>545</b>	<b>32</b>	<b>19</b>
<i>Gjithsej 884 studentë</i>				



#### Aktiviteti shkencor sipas Departamenteve për vitin 2023-2024

	Udhëqje Doktora-ture	Oponenca	Projekte të ndryshme	Referime ne Konferenca brenda vendit	Referime ne Konferenca jashtë vendit	Artikuj shkencorë brenda vendit	Artikuj shkencorë jashtë vendit	Libra/Monografi shkencore	Udhëqje temash diplome
<b>Departamenti i Terapisë Stomatologjike</b>	7		4	251	17	8	13		53
<b>Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike</b>		1	4		22	16	7		20
<b>Departamenti i Kirurgjisë Oro-Maksilofaciale dhe Paraklinike</b>	5		1	8	4	5	3	1	30

### 3.5.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike<sup>10</sup>

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ofron programe studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, të organizuara si më poshtë:

- Programe të ciklit të parë “Bachelor”, me kohëzgjatje 3 vite akademike/180 ECTS (6 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Teknikë Laboratori, Logopedi.
- Programe të ciklit të dytë “Master Profesional”, me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 kredite (7 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Logopedi, Teknikë laboratorit dhe Infermieri Familje.
- Programe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 kredite (6 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Logopedi, Teknik laboratorit.
- 1 Program të ciklit të tretë të studimit Doktoratë në “Shkenca Mjekësore Teknike” me nënfusha, i riaktivizuar në vitin akademik 2023-2024.

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë angazhuar **60** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:


<b>Personel akademik me kohë të plotë, 2023-2024</b>					
<b>Viti akademik</b>	<b>Profesor</b>	<b>Lektor</b>		<b>As. Lektor</b>	<b>Totali</b>
	<b>Prof.</b>	<b>Prof. Asc.</b>	<b>Dr.</b>	<b>Master</b>	
<b>2023-2024</b>	<b>5</b>	<b>21</b>	<b>29</b>	<b>5</b>	<b>60</b>

- 8 % e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 35 % e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,
- 49 % e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 8% e personelit akademik janë “Lektorë”.

Sipas këtyre të dhënave, 92 % e personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, janë me tituj akademikë dhe grada shkencore.

<sup>10</sup> Informacioni është marrë nga Raporti Vjetor 2023-2024, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT

**Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**  
**Personel akademik me kohë të plotë, 2023-2024**



■ Profesor   ■ Profesor i Asociuar   ■ Doktor   ■ Master

Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FSHMT-së angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) dhe njësi të tjera shëndetësore (shërbimit parësor), të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2023-2024</i>			
Viti akademik	Me kohë të pjesshme	SSHU +njësi të tjera Shëndetësore (mbikëqyrës klinik)	Totali
<b>2023-2024</b>	<b>169</b>	<b>118</b>	<b>287</b>


Në FSHMT zhvillojnë veprimtarinë e mësimdhënies në total 347 anëtarë të personelit akademik, personel i UMT 178 (60 me kohë të plotë, 118 personel nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) dhe njësi të tjera shëndetësore (shërbimit parësor); 169 me kohë të pjesshme, si dhe 28 personel ndihmës akademik dhe 17 personel administrativ.

Për vitin akademik 2023-2024, studentë të regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi i studimit	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave
Infermieri	390	46	117
Mami	89	-	16
T. Laboratori	101	19	39
Fizioterapi	96	19	24
T. Imazherie	109	15	34
Logopedi	45	8	25
<b>Total</b>	<b>830</b>	<b>107</b>	<b>255</b>
<i>Në total 1192 studentë të regjistruar në vitin e parë</i>			

Studentë që kanë ndjekur studimet, viti akademik 2023-2024, në të gjitha vitet, janë:

Programi i studimit	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave
Infermieri	1047	46	220
Mami	218	-	16
T. Laboratori	254	19	76
Fizioterapi	249	19	54
T. Imazherie	260	15	61
Logopedi	112	8	47
<b>Total</b>	<b>2140</b>	<b>107</b>	<b>474</b>
<i>Gjithsej 2721 studentë</i>			
<i>+Doktoratë 12</i>			



Gjatë vitit akademik 2023-2024 stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike është angazhuar në aktivitete të edukimit në vazhdim (ka ofruar gjithësej 15.5 kredite të akredituara nga QZHP), aktivitete kërkuese dhe botime, me qëllim final përmirësimin e kapaciteteve akademike.

Për vitin akademik 2023-2024, veprimtaria shkencore ka qenë e fokusuar në atë individuale dhe atë në bazë Fakulteti.

Në mënyrë individuale pedagogët e departamenteve janë angazhuar në aktivitete shkencore, ku përfshihen pjesëmarrje, apo paraqitje punimesh dhe referimesh shkencore, në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në përmbushje të detyrimeve të edukimit në vazhdim.

Pedagogët janë përfshirë në realizimin e botimit të numrit 5 të Revistës Shkencore të FSHMT, si dhe janë angazhuar në punime aktive si autorë të parë apo bashkëautorë në konferencat e organizuara gjatë vitet akademik 2023-2024, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera të arsimit të lartë.

### 3.5 Sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore

**Sekretaria mësimore** është njësi në funksion të procesit mësimor dhe studentëve. Personeli i sekretarisë mësimore është përgjegjës për të gjitha procedurat që ka kryer fakulteti gjatë vitit akademik në lidhje me regjistrimet, transferimet dhe procesin mësimor.

Konkretisht, me fillimin e vitit të ri akademik, sekretaria mësimore:

- kryen regjistrimin e studentëve dhe administron dosjet individuale të tyre;
- menaxhon regjistrat elektronik ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, planeve mësimore për të gjitha vitet, të cilët vazhdojnë studimet në fakultetin përkatës;
- hedh të dhënat dhe gjeneralitetet e secilit student në Regjistrin Themeltar dhe në formë elektronike, për të mundësuar:
  - pajisjen e tij me numër matrikullimi;
  - aktivizimin e studentit elektronikisht në Sistemin për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Pitagora;
- përpilon dhe administron regjistrat e notave ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, planeve mësimore, etj.;
- përpunon të dhënat statistikore për studentët sipas viteve të studimit (femra/meshkuj; fshat/qytet; trojet, shpërndarja sipas grup moshave për studentët e diplomuar, për studentët që kanë kaluar në vitin pasardhës);
- përgatit regjistrat e pedagogëve me emrat e studentëve sipas programeve të studimit dhe grupeve përkatëse për çdo semestër;
- harton procesverbalet në përputhje me kërkesat me shkrim të studentëve, duke u mbështetur në rregulloren e fakultetit.
- harton vërtetimet për ndjekje studimi, si dhe vërtetime të listës së plotë ose të pjesëshme të notave, me kërkesë të studentit;
- verifikon dokumentacionin e ardhur për konfirmim nga Rektorati;
- ofron mbështetje administrative dhe komunikimi me studentët;
- verifikon plotësimin e kushteve dhe kriterëve akademike për kalimin në vitin pasardhës;
- është përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të studentëve.

Gjithashtu, ajo përgatit certifikatën e notave të studentëve të diplomuar dhe mbledh dokumentet e duhura nga studentët për të gjitha shërbimet e kërkuara nga ana e tyre sipas listës së shërbimeve që ofron UMT-ja.

## IV. VEPRIMTARIA AKADEMIKE

### 4.1 Programet e studimit<sup>11</sup>

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ofron në total 88<sup>12</sup> programe të ciklit të parë “Bachelor”, të integruar të ciklit të dytë (PICD), të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, programe të ciklit të tretë “Specializim Afatgjatë”, “Doktoratë” dhe “Master Ekzekutiv”, përkatësisht:

**UMT-ja në vitin akademik 2023-2024** ka miratuar kuotat dhe kriteret e pranimit për programet sipas cikleve, përkatësisht:

- 9 (nëntë) programe studimi të ciklit të parë, **Bachelor** në
  - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi (FSHMT);
  - Shëndet Publik (FM).
  - Teknikë Dentare dhe Higjenist Dentar (FMD)
- 3 (tri) programe studimi të integruara të ciklit të dytë **PICD** (300-360 ECTS)
  - Master i Shkencave në Mjekësi e Përgjithshme (FM)
  - Master i Shkencave në Farmaci (FM)
  - Master i Shkencave në Stomatologji (FMD).
- 9 (nëntë) programe studimi të ciklit të dytë **Master Profesional** (60 ECTS)
  - Menaxhim Infermieror, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi dhe Infermieri Familje (FSHMT);
  - Shëndet Publik dhe Menaxhim Shëndetësor (FM).
- 7 (shtatë) programe studimi të ciklit të dytë **Master i Shkencave** (120 ECTS)
  - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi (FSHMT);
  - Shëndet Publik (FM).
- 37 (tridhjetë e shtatë) programe studimi të ciklit të tretë **Specializime Afatgjata** në fushën e mjekësisë nga të cilat:
  - 35 programe të specializimeve afatgjata (FM)
  - 2 program specializimi afatgjata (FMD).
- 15 (pesëmbëdhjetë) programe studimi të ciklit të tretë “**Doktoratë**” si më poshtë:
  - 13 programe të ciklit të tretë ‘Doktoratë ofrohen nga Fakulteti i Mjekësisë (nga të cilët 1 program i përbashkët me Universitetin e Bolonjës).
  - 1 program doktoratë me 3 nënfusha ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

<sup>11</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, Rektori i UMT-së

<sup>12</sup> Aneksi nr.1\_Lista e programeve të studimit të ofruara në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

- 1 program doktoratë me 3 nënfusha ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, me Urdhër nr.321, datë 27.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është miratuar hapja e programit të studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në “Kirurgji Pediatrike”, program i cili do të aktivizohet për herë të parë në vitin akademik 2024-2025.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, bazuar në strategjinë e zhvillimit 2021-2024 si në përputhje me strategjinë dhe interesat kombëtare të zhvillimit profesional të profesionistëve të shëndetësisë ka identifikuar nevojat për subspecialitete të cilat priten të marrin formën zyrtare të hapjes gjatë vitit akademik 2024-2025.

Programet e studimit që ofrohen në njësitë kryesore të UMT-së, janë objekt rishikimi periodik (çdo fillim viti akademik), në plotësim të standardeve evropiane dhe atyre shtetërore të cilësisë.

Veprimtaritë formuese janë grupuar në kategori sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, “*Për elementët e programeve të studimit...*” e ndryshuar, duke i ndarë në *lëndë bazë* të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme; *lëndë karakterizuese*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; *lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese* në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje; *lëndë plotësuese*, të fokusuar në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat klinike/profesionale të zhvilluara pranë QSUT-së dhe strukturave të tjera universitare dhe jouniversitare shëndetësore, si dhe *tezën e diplomës dhe/ose provimin përfundimtar*.

#### *4.2 Procesi mësimor, mësimdhënia, vlerësimi dhe pranimet*

Mësimdhënia në njësitë kryesore të UMT-së është organizuar në bazë të veprimtarive formuese dhe përbërësve mësimorë të programit të studimit, të cilët ndahen në mësim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, praktika klinike, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor, studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës e praktika profesionale.

Ndarja e orëve mësimore në auditor bëhet në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo lëndë/modul, është e përcaktuar në planet mësimore të programeve të studimit, në bazë të krediteve që ka secila lëndë/disiplinë. Procesi mësimor organizohet në përputhje me profilin e disiplinës, veprimtarisë formuese dhe nivelit të programit të studimit. Personeli akademik ka liri të plotë në organizimin e procesit mësimor, në përputhje me planin e miratuar dhe syllabuset e lëndëve.

Në nivel fakulteti kryhen monitorime periodike për të parë realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar. Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe ruajtja e etikës profesionale të personelit akademik ka qenë në fokus të vazhdueshëm nga fakultetet e UMT-së gjatë vitit akademik 2023-2024. Për këtë qëllim njësitë kryesore monitorojnë procesin mësimor, si dhe metodat e mësimdhënies dhe etikës së komunikimit të stafit me studentët, me qëllim vlerësimin

në tërësi të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në nivel fakulteti.

Informacion lidhur me metodologjitë e vlerësimit të studentëve gjendet në rregulloret e programeve të studimit, rregulloren e fakultetit dhe specifikisht në syllabuset e lëndëve/moduleve. Organizimi i provimeve është semestral ose vjetor në varësi të lëndës dhe programit. Vlerësimi i vazhduar i studentëve u realizua sipas përcaktimeve në syllabuset e lëndëve (testeve dhe detyrave të dhëna nga pedagogët e lëndëve), ndërsa vlerësimi përfundimtar i studentëve u krye nëpërmjet provimeve në auditor.

Rezultatet e studentëve në vite, kompetencat dhe aftësitë profesionale të fituara janë në nivel të kënaqshëm dhe përmbushin kërkesat aktuale të tregut të punës në lidhje me nivelin e kualifikimit, që dëshmon se në UMT diplomohen studentë të aftë profesionalisht për të shërbyer në çdo nivel të shërbimit shëndetësor, brenda dhe jashtë vendit.

### **Pranimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

UMT është i vetmi institucion i arsimit të lartë në vend i cili ka përcaktuar si kriter cilësor në hyrje, notën mesatare për aplikim për secilin nga programet e studimit, përkundrejt notës mesatare minimale (7) përcaktuar me VKM Nr. 436 datë 03.06.2020.

Me vendim të Senatit Akademik të UMT, bazuar në propozimet e njëjësive kryesore për vitin akademik 2023-2024, janë përcaktuar nota minimale mesatare në hyrje, si më poshtë:

- Për programet e integruara të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, “Stomatologji” dhe “Farmaci”  $\geq 8.5$
- Për programet e ciklit të parë  $\geq 7, 7.5$  dhe 8.

Për vitin akademik 2023-2024, Senati Akademik i UMT me Vendim nr. 80, datë 07.10.2022 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.17, datë 22.02.2022...*”, miratoi testimin e informatizuar në lëndët biologji, kimi dhe fizikë, si kriter pranimit për kandidatët në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Mjekësi e përgjithshme”, ku 70% të peshës e kanë pikët e fituara nga arsimit mesëm dhe 30% pikët e fituara nga testimi i informatizuar. Testimi i informatizuar u zhvillua në QSHA, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe UMT “*Për testimin e informatizuar...*”, si dhe Urdhrit nr.183, datë 01.11.2022 “*Për miratimin e rregullores për procedurat...*” të MAS.

### **4.3 Kodifikimi i programeve të studimit<sup>13</sup>**

Në zbatim të nenit 86 të ligjit 80/2015 “*Për arsimin e lartë...*”; VKM nr. 310 datë 11.05.2022, “*Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit...*”; Udhëzimit nr. 31 datë 15.11.2022 “*Për procedurat për kodifikimin*”, si dhe akteve të tjera nënligjore, grupi i punës i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e arsimit të lartë në RSH, realizuan kodifikimin e programeve të studimit. Kodifikimi synon vendosjen e një standardi për diplomat/kualifikimet e dhëna nga IAL në përputhje me Kornizën Kombëtare të

<sup>13</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, Rektorati i UMT-së

Kualifikimeve, duke i dhënë diplomave të njëjtën vlerë ligjore, lehtësimin e karrierës së studentit drejt tregut të punës si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve akademike dhe mobilitetin e studenteve dhe pedagogëve.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ofron programe studimi të cilat klasifikohen në fushën 09 “Shëndet dhe mirëqenie”. Grupi i Punës konstatoi se numrin më të madh të programeve të studimit në fushën 09 e ofron UMT si i vetmi institucion i arsimit të lartë publik në profilin e shëndetësisë (86 programe studimi nga 233 programe në total).

Procesi i kodifikimit të programeve të studimit që ofron UMT është kryer për herë të parë, bazuar në metodologjinë mbi kodifikimin e programeve të studimit sipas përcaktimeve të akteve të sipërcituar dhe në bashkëpunim me njësitë kryesore të UMT.

Kodi i një programi studimi përbëhet nga 9-10 karaktere<sup>14</sup>. Kodi përmban të dhëna mbi ciklin e programit të studimit, kohëzgjatjen e programit, fushën e detajuar, gjuhën në të cilën ofrohet, si dhe nëse është program i përbashkët.

---

<sup>14</sup> Shembull i kodifikimit të programit: Master i Shkencave në Mjekësi e Përgjithshme - Kodi i programit 76MI0912S

76MI: 7 -niveli sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, 6-kohëzgjatja e programit 6 vite akademike; MI- lloji i programit Master i integruar  
0912: Fusha e detajuar, në të cilën bën pjesë programi i studimit (shtojca nr.1, VKM nr. 310, datë 11.05.2022) ,  
S: Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit, shqip, ( shtojca nr.2, VKM nr. 310, datë 11.05.2022).

## V. SIGURIMI I CILËSISË

Sigurimi i cilësisë është një ndër prioritet kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i përfshirë në vizionin dhe misionin e tij, si një institucion që ka ndikim transformues në shoqëri. Ky qëllim realizohet përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, kërkimit shkencor, krijimtarisë dhe sipërmarrjes, me fokus në përgatitjen e profesionistëve të shëndetësisë të aftë për tregun e punës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë si i vetmi institucion publik në fushën e shëndetësisë, synon të jetë një institucion i njohur ndërkombëtarisht për kërkim shkencor dhe inovacion, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të jetës.

Procesi i vlerësimit të cilësisë përfshin monitorimin periodik të arsimit, kërkimit, burimeve njerëzore, financave, infrastrukturës, marrëdhënieve publike dhe ndërkombëtare, si dhe aktiviteteve sociale dhe kulturore. Ky proces, i cili zbatohet në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme, synon të institucionalizojë kulturën e cilësisë dhe të mbështesë zhvillimin e përhershëm të universitetit tonë.

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë...*", Statutit dhe Rregullores së UMT-së; objektiveve të strategjisë së institucionit, UMT është pjesë e vlerësimeve periodike në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.

Në vijim të akreditimit të parë institucional në vitin 2017 nga ekspertët e QAA dhe tri akreditimeve me kohëzgjatje maksimale të programeve të integruara të studimit, Msc. Mjekësi e Përgjithshme, Msc. Farmaci dhe Msc. Stomatologji, UMT ka përfunduar me sukses procesin e riakreditimit institucional, i cili u finalizua me Vendimin nr.3 datë 27.01.2023 "*Për akreditimin periodik të UMT-së...*" të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje maksimale 6 (gjashtë) vjeçare.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, në përputhje me manualin për "*Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit...*" të ASCAL, të gjitha programet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimeve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (19 programe, përkatësisht: 6 Bsc., 7 Mp. dhe 6 Msc.) janë nënshtruar procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Konkretisht, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), të ngritur në nivel programi studimi, në bashkëpunim me strukturat e tjera në njësitë kryesore/bazë, me mbështetjen e Koordinatorit Institucional, NJSBC-së dhe Drejtorisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në Rektoratin e UMT, kanë mundur hartimin e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm dhe përgatitjen e dosjeve të vetëvlerësimit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL dhe Koordinatori i Institucional i UMT, nëpërmjet komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në kohë reale, në sistemin e menaxhimit (AMS).

Procesi i vlerësimit të brendshëm ka mundur një tablo gjithëpërfshirëse për programet e studimit, duke evidentuar njëkohësisht pikat e forta dhe ato që duhen përmirësuar në vijim. Procedura e vlerësimit të brendshëm nuk është parë si një proces mekanik vlerësimi dhe përgatitje dokumentacioni, por ai ka qenë një proces dinamik vlerësimi dhe diskutimi për të paraqitur të plotë gjithë aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor, si dhe njëkohësisht evidentimin dhe adresimin e çështjeve që kanë nevojë për përmirësim.

Në vijim, në përputhje me agjendat e dërguara nga ASCAL, Grupet e Vlerësimit të Jashtëm kanë kryer vizitat në UMT, ku u evidentua angazhimi maksimal i drejtuesve të njësive kryesore dhe bazë të FSHMT, GVB-së, stafit akademik, studentëve, sekretarisë mësimore, etj., si dhe u vendos në dispozicion infrastruktura e nevojshme dhe çdo informacion i kërkuar.

Pas njohjes me draftet dhe raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm, procesi pritet të finalizohet me vendimmarrjet e Bordit të Akreditimit, mbi akreditimin e programeve të studimit dhe kohëzgjatjen e tij.

## VI. PERSONELI AKADEMIK

### 6.1 Personeli akademik<sup>15</sup>

Në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar në total **950** anëtarë të personelit akademik, përkatësisht personel akademik me kohë të plotë, personel akademik që vijnë nga struktura shëndetësore universitare dhe jouniversitare, të huaj, personel i ftuar<sup>16</sup> dhe personel akademik me kohë të pjesshme, si më poshtë:

Personeli akademik i angazhuar në 2023-2024, në UMT	Numri total
Me kohë të plotë	282
SSHU + SSHJU + të huaj	353
Me kohë të pjesshme	315
<b>TOTALI</b>	<b>950</b>

Numri i anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programet e studimit që ofron UMT-ja është **282**.

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2023-2024</i>					
Njësia kryesore	Profesor		Lektor Dr.	As. Lektor ose Master	Totali
	Prof.	Prof. Asc.			
Fakulteti i Mjekësisë	83	79	31	8	201
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	4	7	9	1	21
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	5	21	29	5	60
<b>TOTAL</b>	<b>92</b>	<b>107</b>	<b>69</b>	<b>14</b>	<b>282</b>

Nga të dhënat e tabelave të mësipërme rezulton se **95%** e të gjithë personelit akademik me kohë të plotë në nivel universiteti janë me tituj akademik ose gradë shkencore (**33%** janë me titull “Profesor”, **38%** me titullin “Profesor i Asociuar” dhe **24%** me gradën shkencore “Doktor”).

Referuar të dhënave nga sektori i burimeve njerëzore, evidentohet se të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë në UMT plotësojnë detyrimin ligjor për sa i përket personelit akademik dhe titujve akademikë dhe gradave shkencore.

UMT-ja, ka në përbërje të saj strukturat shëndetësore universitare (ligji nr. 80/2015, neni 28) dhe departamentet, si njësi bazë, kanë në përbërjen e tyre shërbime dhe specialitete të ndryshme, në varësi të funksionit të veprimtarisë së tyre. Shërbimet kryejnë funksion të dyfishtë: akademik dhe kërkimor-shkencor si njësi akademike të UMT-së, si dhe shërbim terciar, diagnostikues e trajtues, si njësi të strukturës shëndetësore universitare spitalore të sistemit shëndetësor në vend. Në bazë të kësaj strukture, kryhet aftësimi akademik, praktik e klinik i studentëve, specializantëve, si dhe veprimtaria kërkimore-shkencore e doktorantëve dhe e personelit akademik, si dhe njëkohësisht ofrohet shërbim shëndetësor ndaj popullatës.

<sup>15</sup> Informacioni është marrë nga raportet vjetore të njësive kryesore.

<sup>16</sup> Personel akademik me kohë të plotë në FM, të cilët angazhohen edhe në FMD.

Nisur nga kjo formë organizimi dhe funksionimi, praktikisht e gjithë infrastruktura dhe kapacitetet njerëzore të qendrave spitalore universitare në vend, përveç ofrimit të shërbimit shëndetësor, janë njëkohësisht në funksion të edukimit e kërkimit shkencor mjekësor, si pjesë e UMT-së (VKM-të përkatëse për krijimin e strukturave shëndetësore universitare në vend). Në këtë kuadër, në mbështetje të procesit mësimor në UMT, për vitin 2023-2024 janë angazhuar si personelit mbikëqyrës akademik (SSHU), të punësuar më kohë të plotë në strukturat shëndetësore në vend.

Personel akademik i ftuar dhe i huaj i angazhuar në UMT janë rreth 12.5%, personel akademik me kohë të pjesshme (që vijnë nga IAL-të e tjera) janë 43%, ndërsa SSHU + struktura të tjera janë rreth 44.5 %.

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme në UMT, për vitin akademik 2023-2024</i>					
<b>Njësia kryesore</b>	<b>Të jashtëm</b>	<b>SSHU + Str. të tjera shëndetësore</b>	<b>Të ftuar</b>	<b>Të huaj</b>	<b>Totali</b>
Fakulteti i Mjekësisë	61	204	-	-	<b>265</b>
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	85	-	59*	31	<b>175</b>
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	169	118	-	-	<b>287</b>
<b>TOTAL</b>	<b>315</b>	<b>322</b>	<b>59</b>	<b>31</b>	<b>727</b>

*\*Personel akademik me kohë të plotë i Fakultetit të Mjekësisë që angazhohet edhe pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare*

Procedura për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të pjesshme kryhet çdo vit në përputhje me nevojat që kanë njësitë bazë për mbulimin e ngarkesës mësimore. Ngarkesa mësimore është planifikuar dhe realizuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtaritë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, për vitin akademik 2023-2024.

## VII. KËRKIMI SHKENCOR<sup>17</sup>

Gjatë vitit akademik 2023-2024, UMT ka forcuar bashkëpunimet me universitete dhe qendra kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Janë 110 memorandume bashkëpunimi aktive dhe për projektet ndërkombëtare *ongoing*, janë atribuar 622 913 Euro grante ndërkombëtare, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve kërkimore.

Kërkimi shkencor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e fushave të shëndetit. Ky universitet, i njohur për angazhimin e tij në fushën e shkencave shëndetësore, është një qendër e rëndësishme për formimin e profesionistëve të shëndetësisë dhe zhvillimin e teknologjive dhe trajtimeve të reja.

Një nga pikat kyçe të kërkimit shkencor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë është bashkëpunimi me institucione të tjera akademike dhe shëndetësore, si dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare që mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe informacionit me grupe kërkimore të nivelit të lartë. Ky bashkëpunim sjell mundësi për zhvillimin e hulumtimeve të avancuara, që synojnë të ofrojnë zgjidhje për problematikat më të rëndësishme shëndetësore të vendit dhe të rajonit.

Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të numrit të publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjeve në konferenca ndërkombëtare. Kjo tregon angazhimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për të kontribuar në avancimin e mjekësisë dhe shkencës shëndetësore në përgjithësi.

Përveç kësaj, UMT ka krijuar mundësi të shumta për doktorantët që të përfshihen në projekte kërkimore, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e ideve të reja dhe inovative. Kjo përfshin aksesin në laboratorë të pajisur me teknologji të avancuar, si dhe mundësinë për të bashkëpunuar me ekspertë të fushave të ndryshme, që mundëson zhvillimin e aftësive të kërkimit dhe analizës shkencore.

### 7.1 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti<sup>18</sup>

#### 1. Lista e marrëveshjeve me IAL ndërkombëtare

Aktualisht, UMT ka 43 marrëveshje aktive me IAL ndërkombëtare, si më poshtë:

Nr	Institucioni	Kohëzgjatja
1	Universiteti i Chieti, Pescara, Itali (Gabriele D'Annunzio)	5-vjeçare
2	Universiteti "Aldo Moro", Itali	5-vjeçare
3	Universiteti i Strugës, Maqedoni e Veriut	5-vjeçare
4	Universiteti "Hasan Prishtina, Kosovë	3-vjeçare
5	Universiteti "Biznes dhe Teknologji", Kosovë	6-vjeçare
6	Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan, Kosovë	4-vjeçare
7	Kolegji "Rezonanca", Prishtinë, Kosovë	4-vjeçare
8	Universiteti i Tetovës, Maqedoni e Veriut	4-vjeçare

<sup>17</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektorati i UMT

<sup>18</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektorati i UMT

9	Universiteti Pitești, Rumani	5-vjeçare
10	Universiteti Tor Vergata, Romë	5-vjeçare
11	Universiteti i Trakias, Turqi	5-vjeçare
12	Universiteti Teramo, Itali	5-vjeçare
13	Tallinn Health Care College, Estoni	Pa afat
14	Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë	3-vjeçare
15	Kolegji Heimerer, Kosovë	4-vjeçare
16	Universiteti i Janinës, Greqi	4-vjeçare
17	International European University, Ukrainë	5-vjeçare
18	The Berlin School of Health Sciences, Berlin, Gjermani	Pa afat
19	Semmelweis University, Hungary	Pa afat
20	Universiteti Novi Sad, Serbi	Pa afat
21	Universiteti i Romës "La Sapienza", Itali	5-vjeçare
22	Universiteti Ndërkombëtar I Shkencave të Shëndetit Saint Camillus, Itali	5-vjeçare
23	Universiteti I Mjekësisë dhe Farmacisë së Kraiovës, Rumani	5-vjeçare
24	International European University, Ukrainë	5-vjeçare
25	Universiteti SS.Cyriand Methodius University, Shkup, Maqedoni e Veriut	3-vjeçare
26	Universiteti i Beogradit	4-vjeçare
27	Universiteti i Shkencave Mjekësore, Turqi	5 vjeçare
28	Universiteti "Altinbas", Turqi	5-vjeçare
29	Universiteti Lazarski, Varshavë, Poloni	4-vjeçare
30	Universiteti i Mjekësisë dhe Farmacisë "Griogore T. Popa", Rumani	5-vjeçare
31	Universiteti i Firatit, Turqi	5-vjeçare
32	Universiteti i Foxhia-a, Itali	4-vjeçare
33	Universiteti i Salerno-s, Itali	5-vjeçare
35	Univeristetit Telematik "Leonardo Da Vinci", Itali	Pa afat
36	Universiteti i Mjekësisë, Azerbajxhan, Baku	Pa afat
37	Universiteti i Shkencave Shëndetësore Afyonkarahisar, Turqi	5-vjeçare
38	Universiteti Mjekësor Wroclow, Poloni	Pa afat
39	Universiteti i Saarland, Gjermani	Pa afat
40	Universiteti i Bolonjës, Itali	Pa afat
41	Shkolla Verore Vascern, Paris, Francë	Pa afat
42	Royal College of Surgeons ne Irlandë	2021-2027
43	Universiteti i Janinës, Greqi	Pa afat

## 2. Lista e marrëveshjeve me IAL kombëtare

UMT ka 17 marrëveshje aktive me IAL të tjera kombëtare.

Nr.	Institucioni	Kohëzgjatja
1	Universiteti Aldent, Tiranë	4 vjeçare
2	Unniversiteti European i Tiranës, Tiranë	2 vjeçare
3	Universiteti Luarasi, Tiranë	4 vjeçare
4	Western Balkans University, Tiranë	4-vjeçare
5	Universiteti Polis, Tiranë	5- vjeçare
6	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë	4-vjeçare
7	Universiteti "Albanian University", Tiranë	4-vjeçare
8	Universiteti Ismail Qemali, Vlorë	2-vjeçare

9	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	4-vjeçare 5- vjeçare
10	Universiteti Fan S.Noli, Korçë	4-vjeçare
11	Universiteti Aleksandër Xhuvani Elbasan	4-vjeçare
12	Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	4-vjeçare
13	Universiteti Bujqësor i Tiranës	4-vjeçare
14	Kolegji i Lartë Profesional TESS, Tiranë	4-vjeçare
15	Universiteti Eqrem Cabej, Gjirokastër	4-vjeçare
16	Universiteti Marin Barleti, Tiranë	1 vjecare
17	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	5-vjeçare

### 3. Lista e marrëveshjeve me institucione të tjera

Në vitin akademik 2023-2024, UMT ka patur 25 marrëveshje aktive me institucione të tjera.

Nr	Institucioni	Kohëzgjatja
1	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Tiranë	Pa afat
2	Albanian-American Development Foundation, Tiranë	4 vjeçare
3	Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë	Pa afat
4	Oda e Farmacistëve të Kosovës, Kosovë	2 vjeçare
5	Abc Health foundation, Tiranë	5- vjeçare
6	New Generation, Tiranë	4- vjeçare
7	AMPLE, Tiranë	4-vjeçare
8	FU farma, Tiranë	2-vjeçare
9	Pro farma, Tiranë	2-vjeçare
10	Florfarma, Tiranë	4-vjeçare
11	International Youth Fellowship, Tiranë	Pa afat
12	Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë	1-vjecare
13	Qendra nderinstitucionale e rrjetit akademik shqiptar (RASH), Tiranë	Pa afat
14	Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore, Tiranë	2 vjecare
15	Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe pajisjeve mjekësore, Tiranë	2 vjecare
16	Lekli Pharma, Tiranë	2 vjecare
17	Organizata Jo-fitimprurëse Akademi Foundation, Tiranë	1 vjeçare
18	Fidia Pharma Group, Itali	2 vjecare
19	Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për fëmijët, Tiranë	2 vjecare
20	SAE Investments dhe Hamida Pharma Ltd	5 vjeçare
21	Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë	4 vjeçare
22	Spitali Royal Brompton Londer Angli/ Guys and St Thomas NHS Foundation, Angli	Pa afat
23	Grupi Spitalor i Rajonit Mulhouse Sud Alsace, Francë	Pa afat
24	Albanian Health Fund, Tiranë	4 vjeçare
25	Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë, Tiranë	Pa afat

## 7.2 Projekte<sup>19</sup>

### 1. Lista e projekteve kombëtare të aplikuara pranë AKKSHI-t (përmbledhje e projekteve të tri njësisve kryesore dhe rektoratit)

Për periudhën 2023-2024, janë paraqitur gjithsej 17 projekt propozime për Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), në vijim të thirrjeve të publikuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Gjatë vitit 2023, janë paraqitur 8 projekt-propozime, ndërsa në vitin 2024 janë dorëzuar 9 projekt-propozime të tjera. Ndërkohë për sa i përket thirrjes për projekte të Infrastrukturës dhe Kërkimit Shkencor, si dhe për Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit, për periudhën 2023-2024 ka patur gjithsej 10 projekt propozime, 6 për vitin 2023 dhe 4 për vitin 2024. Ky angazhim tregon rritjen e interesit të stafit akademik të UMT në iniciativat e kërkimit shkencor dhe zhvillimit të inovacionit në nivel kombëtar.

Gjithashtu, UMT ka shprehur interesin edhe në Thirrje të tjera kombëtare si ato të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për financimin e IAL-ve publike në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2023-2024. Në këtë thirrje, personeli akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë ka paraqitur 4 projekt-propozime.

### 2. Lista e projekteve kombëtare të fituara pranë AKKSHI (ongoing)

Viti	Nr.	Titulli	Përshkrimi
2018	1.	Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simultante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme. Një studim eksperimental.	Qëllimi i studimit është implantimi i suksesshëm i qelizave staminale autologe CD133+ në mënyrë simultane me revaskularizimin transmiokardial me lazer në zonën e infarktuar të miokardit bë konkomitancë me revaskularizimin kirurgjikal duke u evidentuar si rezultat përfundimtar vdekshmëria postoperatore, infarkti akut i miokardit perioperator, ngjarje madhore kardiake dhe cerebrovaskulare të evidentuar si MACCE.
2019	1.	Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simultante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të	Qëllimi i studimit është implantimi i suksesshëm i qelizave staminale autologe CD133+ në mënyrë simultane me revaskularizimin transmiokardial me lazer në zonën e infarktuar të miokardit bë konkomitancë me revaskularizimin kirurgjikal duke u evidentuar si rezultat përfundimtar vdekshmëria postoperatore, infarkti akut i miokardit perioperator,

<sup>19</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtorja e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektorati i UMT

		ndryshme. Një studim eksperimental.	ngjarje madhore kardiake dhe cerebrovaskulare të evidentuar si MACCE.
2.		Aplikimi i imunocitometrisë me fluks në studimin e funksionit fagocitar dhe limfocitar si dhe në imunofenotipizmin qelizor të nyjeve limfatike.	Ky projekt ka rëndësi të vecantë për implementimin e një teknologjie të re laboratorike mjekësore si ne fushën diagnostike dhe atë kërkimore. Citometria me fluks është një teknike laboratorike që ka një rëndësi të vecantë në diagnozën mjekësore nëpërmjet studimit të markuesve qelizorë në të gjitha qelizat e organizmit dhe vecanërisht në qelizat e gjakut dhe të palcës kockore. Gjithashtu kjo metodologji ka një vlerë të rëndësishme dhe në kërkimin shkencor në fushat e bioteknologjisë, si ato fundamentale ashtu dhe në sëmundjet e ndryshme, si psh sëmundjet e gjakut, sëmundjet onkologjike, sëmundjet autoimune, mangesitë e sistemit imunitar etj. Teknologjia e citometrisë me fluks nuk ekziston aktualisht në asnjë laborator akademik/laboratorik në vendin tonë. Implementimi për herë të parë i kësaj teknologjie në sektorin kërkimor dhe mësimdhënës të Shërbimit të imunologjisë në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës do të ketë një vlerë të rëndësishme si në edukimin e studentëve të ciklit të integruar të këtij universiteti ashtu dhe në ciklin e tretë sic janë specializimet afatgjata në mjekësi dhe doktoratat. Teknologjia e citometrisë me fluks do të bëjë të mundur realizimin dhe të studimeve shkencore kërkimore në fushat biomjekësore duke përfshirë dhe realizimin e doktoratave si dhe të studimeve post-doktorale në këto fusha.
3.		Aplikimi i teknologjisë dixhitale në stomatologji.	Qëllimet specifike të projektit janë rritja e cilësisë së shërbimit në trajtimin e pacientëve të ndryshëm me mungesa të dhëmbëve, rritja e nivelit në përgatitjen teorike dhe praktike të studentëve, përdorimin e metodave të reja bashkëkohore në punën me pacientë, përdorimin e një gamë të gjerë materialesh bashkëkohore.
<b>20</b> <b>20</b>	1.	Sonda molekulare me bazë Flour për Diagnostikimin e Hershëm të Sëmundjeve Neurodegenerative nëpërmjet Teknikave të Rezonancës Magnetike.	Projekti synon të sigurojë sonda specifike molekulare me bazë F MRI për diagnostikimin e hershëm të AD dhe PD përmes zbulimit të pllakave amiloide dhe funksioneve jonormale dopaminergjike, përkatësisht. Ky është një hap thelbësor drejt zbatimit të teknikave më të besueshme, më të sigurta dhe më të shtrenjta të MRI si alternativë ndaj mjeteve diagnostikuese invazive dhe shumë të shtrenjta të përdorura aktualisht, siç është Tomografia e Emisionit të Pozitronëve (PET), të cilat varen nga gjurmuesit radioaktiv dhe janë në dispozicion vetëm në strukturat e specializuara.

20 21	1.	Efektet afatmesme dhe afatgjata të infeksionit nga SARS-CoV-2 në funksionin pulmonar tek moshat e reja post COVID-19 në Shqipëri. Determinimi i rolit të atopisë dhe sensitivizimit nga pneumoalergenët, si tregues i mbizotërimit të inflamacionit TH2 në raport me severitetin klinik të COVID-19 në këtë popullatë.	Ky projekt do të përfaqësojë studimin e parë në popullatën Shqiptare, për vlerësimin e pasojave afatmesme dhe afatgjata të COVID-19 në funksionin pulmonar. Vlerësimin e rolit të inflamacionit alergjik TH2 në patogenezën e COVID-19 të mesëm - të rëndë. Hartimi i rekomadimeve mbi ndjekjen dhe minimizimin e pasojave pulmonare të COVID-19 në pacientët e sensitivizuar nga pneumoalergenët.
20 22 ( P K K Z H)	1.	Patogjenët e rinj dhe siguria transfuzionale	Patogjenët e rinj që përhapen përmes transfuzionit. Patogjenët e rinj janë ata patogjenë për të cilët gjaku nuk testohet dhe për të cilët konstatohet globalisht se incidenca e tyre është rritur në dy dekadat e fundit apo parashikohet një rritje e incidencës në të ardhmen. Kjo mund ti dedikohet evolucionit të një organizmi ekzistues, përhapjes së një agjenti infektiv të ri, njohjes së një infeksioni që ka qenë prezent në popullatë por ka kaluar pa u zbuluar.
	2.	Krahasimi ndërmjet protezave totale të lëvizshme të konstruara me sistemin SR IVOCAP dhe sistemin tradicional.	Qëllimi i studimit është konstruktimi i protezave totale të lëvizshme me teknikën tradicionale dhe me teknikën e injektimit me presion. Krahasimi i protezave të polimerizuara me dy teknika: tradicionale dhe me sistemin SR-IVOCAP.
2 0 2 3 ( P K K Z H )	1.	Çrregullimi i aftësive njohëse në pacientë me sëmundje kronike të veshkave	Fokusi i këtij projekti është të investigojë faktorët e riskut, dekursin klinik, prognozën dhe mortalitetin në pacientet me sëmundje kronike të veshkave dhe dëmtim konjitiv, për herë të parë në vendin tonë. Studimi synon të vlerësojë ndryshimet në indikatorët imunitarë dhe laboratorikë faktorët e riskut për dëmtimin konjitiv në pacientë me sëmundje kronike të veshkave, në mënyrë që të nderhyjë në kohë për parandalimin e progresionit të sëmundjes.
	2.	Markuesit imunologjikë dhe imunogjenetikë në sëmundjet autoimmune të gjendres tiroide	Qëllimi i këtij projekti është evidentimi i faktorëve gjenetikë të lidhur me shfaqjen e sëmundjeve autoimmune të tiroides në popullatën shqiptare dhe lidhja e mundshme e këtyre faktorëve me faktore ambientale specifike.
	3.	Infeksionet kirurgjikale dhe trajtimi i tyre para dhe pas përmirësimit infrastrukturor.	Duke pasur parasysh ndryshimet në strukturën kirurgjikale e cila tashmë është modernizuar sipas parametrave ndërkombëtare, me këtë ndryshim rrjedhimisht kemi ndryshime në cilësinë pre, intra dhe post operatore. Ndërkohë që mungojnë të dhënat për

		<p>këto komplikacione postoperatore që në vendet e zhvilluara të EU si psh; Itali, Francë, Gjermani dhe në U.S.A përbëjnë rreth 11-20%. Qëllimi i këtij projekti është që të krijojë një bazë të dhënash të përditësuar për këtë problematikë me impakt jo të vogël mjekësor dhe social-ekonomik, për të arritur në një përmirësim të parandalimit dhe trajtimit sipas kushteve të tanishme dhe duke u bazuar në guidlinet ndërkombëtare.</p>
4.	<p>Konsumi mesatar ditor i kripës në popullatën e Republikës të Shqipërisë.</p>	<p>Të investigojë ekskretimin mesatar të natriumit në urinën 24 orëshe si një indikator për konsumin e kripës në popullatën shqiptar. Objektivat e këtij studimi do të jenë vlerësimi i sekretimit të natriumit në mostrat e urinës 24 orëshe për një kampion të popullsisë shqiptare si një shënues për marrjen e kripës në shqiptarët adultë. Ka disa mënyra për të matur marrjen e kripës. Këto përfshijnë rikujtimin ose regjistrimin e dietës nga 24 deri në 96 orë, metodat e pyetësorit të shpeshtësisë së ushqimit dhe mbledhjen e urinës 24-orëshe. Vlerësimi i saktë i marrjes së kripës është i vështirë sepse sasia e kripës së shtuar gjatë gatimit (madje edhe në restorante) dhe në tryezë zakonisht nuk dihet. Më tej, është e vështirë të përcaktohet sasia e kripës që mbetet në një pjatë servirje dhe të përcaktohet përmbajtja e kripës në ushqim dhe në ujën e pijshëm. Në përgjithësi, mbledhja e urinës 24-orëshe konsiderohet të jetë metoda më e besueshme për të vlerësuar marrjen e kripës</p>
5.	<p>Identifikimi i faktorëve tradicionalë dhe jotradicionalë të rrezikut kardiovaskular në Sëmundjen Renale Kronike</p>	<p>Identifikimi i faktorëve tradicionalë dhe jotradicionalë të rrezikut kardiovaskular tek popullata me sëmundje renale kronike dhe impakti që këa faktore kanë në morbiditetin dhe mortalitetin kardiovaskular. Gjithashtu, identifikimi i faktorëve të rinj, karakteristike për këtë grup popullate, të paevidentuara nga studimet e mëparshme, do t'i jepte një rëndësi të vecantë këtij studimi dhe do të shërbente si një burim informacioni jo vetëm në nivelin konstatues, por edhe në nivel parandalues, ku një rol të rëndësishëm do të luajnë alternativat e reja të mjekimit.</p>
6.	<p>Onko-Nefrologji Nje fushe e re ne mjekesine moderne</p>	<p>Qëllimi i projektit është të sigurojë kujdes të specializuar për pacientët me kancer që kanë probleme të lidhura me veshkat, duke përfshirë parandalimin dhe menaxhimin e efekteve nefrotoksike të trajtimeve kundër kancerit dhe adresimin e komplikacioneve të</p>

			veshkave që mund të shfaqen te pacientët me kancer per herë te parë në Shqipëri.
<b>C N R 20 23</b>	1.	Përdorimi i teknikave të reja të mikroskopisë me dy foton duke përdorur substanca fluorofori për studimin e cifteve neurovaskulare	Vlerësimi i funksioneve dhe mosfunksionimit të trurit mbeshitet gjerësisht ne metodat e neuroimazherise. Keshtu, FMRI dhe zhvillimi i metodave te inteligjences artificial po mundesojne kuptimin e disa aspekteve te proceseve neurologjike dhe patologjike te trurit. Ne kete project synohet te zhvillohen molekula organike fluoeshente target qe mund te funksionojne si sonda ne 2 PM ne studimin e NVC-ve, si pjese e nje perpjekje me te gjerë për të gjetur një metodë tërësisht optike për të hulumtuar sistematikisht NVC në të gjithë zonat e trurit dhe ndërlidhjen shkakësore midis ndryshimeve të qarkullimit të gjakut dhe sëmundjes Alzheimer.
<b>20 23 (I nf ra st ru kt ur ë - Te kn ol og ji)</b>	1.	Modernizimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore në Departamentin e Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Qëllimi i këtij projekti është mundësimi i infraskturës së nevojshme për ofrimin e mënyrave bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies dhe kërkimit shkencorë pranë Departamentit të Lëndëve Biomjekësore Eksperimentale, në përmbushje të planeve mësimore për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë Specializimeve Afatgjatë dhe Doktoratë. Përfshirja aktive e studentëve për realizimin e projektit kërkues ne vlerësimin e rolit të nivelit të vitaminës D serike në fiziologjinë e sistemit nervor periferik.
	2.	Prodhimi dhe aplikimi i formave farmaceutike inovative me bime mjekesore si alternative e perdorimit te antimikrobikeve	Qëllimi i këtij projekti është të identifikojë bimët aromatike me veprime terapeutike antibakteriale dhe të formulojë me ekstrakte e tyre forma farmaceutike dermatologjike inovative me si alternativë e përdorimit të antimikrobikëve
	3.	Përdorimi i një sistemi polimerik në optimizimin e biodisponibilitetit të barnave. Zhvillimi industrial i një bari cilësor dhe kosto-efikas për popullatën shqiptare	Qëllimi i këtij studimi është përdorimi i kombinuar i kopolimerëve anionike të acidit metakrilik-akrilat etilik dhe hidroksipropil metil celulozës për formulimin e veshjes gastro-rezistente të tabletave duke përdorur diklofenak natrium si bar tip. Hidroksipropil metil celuloza do të pëdoret si një polimer enterik, kurse kopolimeri anioniki i acidit metakrilik-akrilat etilik do të përdoret për të siguruar fazën shtesë të vonesës, që siguron çlirimin e barit në pjesën e poshtme të traktit gastro-intestinal.

<p><b>20</b> <b>24</b> <b>P</b> <b>K</b> <b>K</b> <b>Z</b> <b>H</b></p>	<p>1.</p>	<p>Vlerësimi i punimeve protetike totale të lëvizshme të përgatitura nëpërmjet masës terciare përkundrejt metodës konvencionale</p>	<p>Qëllimi i studimit tonë është përcaktimi i efikasitetit të përdorimit të masës piezografike (terciare) në protezat totale, sidomos në nofulla të poshtme të vogla dhe atrofi të klasës së tretë. Gjithashtu, qëllim i studimit është përcaktimi i hapësirës neutrale të ekuilibrit protetik në mënyrë funksionale tek pacientët (nëpërmjet metodës fonetike dhe lëvizjeve funksionale) dhe respektimi i saj në konstruktimin e protezës totale.</p>
	<p>2.</p>	<p>Vlerësimi i nivelit të vitaminës D në pacientët me sëmundje alergjike në aktivitet të rritur të sëmundjes</p>	<p>Vlerësimi i nivelit të Vitaminës D në popullatën e pacientëve me sëmundje alergjike në aktivitet të lartë, (të pakontrolluara nga mjekimet ambulatorë) për Astma Bronkiale Alergjike dhe Urtikarie Kronike në korrelacion me BMI.</p>
	<p>3.</p>	<p>Përmirësimi i Vlerësimit dhe Menaxhimit të Dhimbjes Kronike Jo-Onkologjike në Shërbimin Shëndetësor Parësor</p>	<p>Qëllimi i projektit është identifikimi i praktikës aktuale të vlerësimit dhe menaxhimit të dhimbjes kronike jo-onkologjike në mjediset e kujdesit shëndetësor parësor, me objektiv përmirësimin nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të personelit shëndetësor të kujdesit parësor mjekë dhe infermierë të familjes, me impakt në rritjen e cilësisë së kujdesit të ofruar dhe reduktim të kostove shëndetësore të lidhura me këtë problematikë.</p>
	<p>4.</p>	<p>Cilësia e jetës në pacientët me kancer në Shqipëri</p>	<p>Qëllimi i projektit është vlerësimi i cilësisë së jetës në pacientët me kancer të diagnostikuar dhe trajtuar në Qendrën Spitalore Universitare “ Nënë Tereza”, rolin e vlerësimit të hershëm i cilësisë së jetës në mortalitetin e hershëm të pacientëve me kancer dhe krijimi i një baze të dhënash mbi cilësinë e jetës tek pacientët me kancer e cila do të shërbejë për krijimin e algoritmeve të qarta të strategjisë së ndjekjes dhe identifikimit të faktorëve që ndikojnë në përmirësimin ose përkeqësimin e cilësisë së jetës tek pacientët me kancer me pikësynim e përmirësimin të shërbimit ndaj të sëmurit.</p>
	<p>5.</p>	<p>Krijimi i databazës spitalore universitare për kancerin e stomakut, një nevojë për trajtimin optimal në dritën e protokolleve të reja terapeutike</p>	<p>Qëllimi i projektit është të vlerësojë peshën e kancerit të stomakut (KS) në Shqipëri duke dhënë një panoramë epidemiologjike, kohën nga diagnoza në trajtim dhe stadin e paraqitjes së sëmundjes.</p>

	6.	Efektet e trajtimit me SGLT2-inhibitore ne parametrat metabolike dhe funksionin kardiak e renal	Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojmë nëse inhibitorët e SGLT-2 sjellin vërtetë përmirësime në jetëgjatësinë e pacientëve, në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe në uljen e kostove spitalore për shkak të reduktimit të dekompensimit të insuficiencës kardiake, në popullatën shqiptare. Përpunimi me Inteligjencë Artificiale (nga Universiteti i Sorbones) i të dhënave të EKG-së synon të nxjerrë në pah nëse këto medikamente kanë ndikim Pozitiv apo Negativ në EKG
	7.	Zbulimi i hershem dhe strategjite e nderhyrjes Nefroprotektive per demtimin akut renal ne terapine intensive: Nje qasje multidisiplinare	Qëllimi i këtij projekti është identifikimi i faktorëve të riskut dhe i treguesve të hershëm të Dëmtimit Renal Akut te pacientët në Terapinë Intensive. Ky studim nënvizon rolin kritik të identifikimit të shpejtë të DAR dhe ndërhyrjes së hershme nefroprotektive në parandalimin dhe avancimin e DAR, duke mbrojtur kështu funksionin e veshkave e duke ulur morbiditetin dhe mortalitetin në pacientët në terapi intensive.
	8.	Retinopatia e prematuritetit, vlerësim i incidencës, i faktorëve të riskut, diagnostikimi, trajtimi në kohë dhe strategjitë parandaluese	Qëllimi i projektit është parandalimi i verbërisë në fëmijët prematurë. Të hulumtoje mbi incidencën, gravitetin e RP dhe të ndihmojë në hartimin e një protokollit depistimi, diagnostikimi, trajtimi dhe monitorimi të pacientëve me RP.  Hapat qe duhet të ndiqen dhe protokolllet që duhet të hartohen për ndjekjen në dinamikë me qëllim minimizimin e invaliditetit tek këta të sëmurë.
<b>PI K S H 20 24</b>	1.	Përmirësimi cilësor i infrastrukturës së Labororit të Biologjisë Molekulare në shërbimin e Labororit të Gjenetikës Klinike me aplikimin e teknikave gjenomike të avancuara (Next Generation Sequencing)	Qëllimi i ketij projekti është të krijojë infrastrukturë për aplikimin e teknikave bashkëkohore për për të kryer kërkim shkencor në fushën e BM. Duke investuar në paisje dhe teknologji të reja, ne krijojme mundesine per diagnozen molekulare te te semundjeve me prevalence te larte si sëmundjet neuromuskulare, si dhe aplikimin e teknikave molekulare te avancuara per diagnozen dhe trajtimin e hemopative malinje dhe tumoreve solide. Përmirësimet në infrastrukturë mund të çojnë në krijimin e rezultateve më të detajuara dhe më të besueshme pasi paisjet dhe metodat molekulare të avancuara ofrojnë një nivel më të lartë të saktësisë dhe ndjeshmërisë.

	2.	Ndërtimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore për analizën e çrregullimeve të sistemit vestibular	Infraktruktura e propozuar synon të krijojë një ambient të specializuar për diagnostifikimin, trajtimin dhe kërkimin shkencor të sëmundjeve vestibulare. Qëllimi i këtij projekti është të ofrojë një qendër të specializuar dhe të avancuar që të kushtohet plotësisht përmirësimit të shëndetit të pacientëve me sëmundje të sistemit vestibular.
	3.	Krijimi i Labororit të Simulimit Virtual të Imazherisë Diagnostike në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike	Ky projekt propozim ka për synim rritjen e kapaciteteve akademike dhe shkencore të UMT dhe FSHMT në përdorimin e teknologjive të reja simulative të imazherisë mjekësore nëpërmjet krijimit të një laboratorit didaktiko-shkencor të simulimit, vizualizimit dhe procesimit të imazheve digjitale mjekësore. Qëllimi kryesor është krijimi i një qendre në fushën e imazherisë mjekësore për simulimin virtual të teknikave të avancuara diagnostike si dhe zhvillimin e kompetencave për mbrojtjen nga rrezatimi.

### 3. Lista e Projekteve Kombëtare të fituara pranë MAS

<b>M a s 2 0 2 2</b>	1.	Aplikimi i Teknologjisë Dixhitale në Stomatologji, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë	Ka për qëllim rritjen e nivelit shkencor të mësimdhënies nëpërmjet aplikimit të metodave bashkëkohore në fushën e protetikës dhe kirurgjisë
	2.	Vlerësimi i protezave fikse metal qeramike të mbështetura mbi implante, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë	Të përcaktojë shkallën e mbijetesës dhe suksesit me kalimin e kohës të protezave totalisht qeramike dhe metal qeramike të mbështetura mbi implante.
<b>M a s 2 0 2 3</b>	1.	Digitalizimi i njësisë laboratorike të Histologjisë	Projekti synon të krijojë një njësi laboratorike (katër laboratore moderne didaktiko-mësimor të lëndës së Histologji-Embriologjisë). Kjo synohet të realizohet katër mjedise për realizimin e procesit të mëimit praktik në lëndën e Histologjisë të FM. Ky projekt përfshihet në planet e zhvillimit strategjik të FM për modernizimin e procesit mësimor të lëndëve bazë të këtij fakulteti.
	2.	Digitalizimi i Diseksionit Virtual dhe ristrukturimi i njësisë Laboratorike të Anatomisë	Modernizimi i laboratorëve të Anatomisë Normale në Fakultetin e Mjekësisë përplotëson nevojat e kërkimit shkencor në të gjitha aspektet e Anatomisë së Aplikuar dhe Klinike, duke përmirësuar infrastrukturën didaktike dhe kërkimore-shkencore në mënyrë bashkëkohore.

3.	Mbështetja dhe fuqizimi infrastrukturor i Laboratorëve të praktikës profesionale, pranë FSHMT-së	Qëllimi final i projektit do të ishte venia në dispozicion të studenteve e sa më tepër baze material për praktikën e tyre profesionale, me produkt formimin praktik në përputhje me kërkesat e kohës.
----	--	---

#### 4. Lista e projekteve ndërkombëtare të fituara

Acronym	Project Number	Title	Programme
MEDIGENE	279171	Genetic and environmental factors of insulin resistance syndrome and its long-term complications in immigrant Mediterranean populations	FP7
EUSCREEN	733352	Implementation of cost-optimized childhood vision and hearing screening programmes in middle-income countries in Europe	H2020
GRaduates Advancement and Development of University capacities in Albania	585961	GRaduates Advancement and Development of University capacities in Albania	EPLUS
Quality development of international cooperation and project management	609786	Quality development of international cooperation and project management	EPLUS
DigiCare4You	945246	An intersectoral innovative solution involving DIGItal tools, empowering families and integrating community CARE services for the prevention and management of type 2 diabetes and hypertension	H2020
Inclusive tertiary Education in the West Balkans	618859	Inclusive tertiary Education in the West Balkans	EPLUS
ScaleUp4Health	825838	Scaling-up interventions for the prevention of diabetes and hypertension among families in Europe and Asia	H2020
BIOSINT	101082863	Strengthening capacities and digital competences in biomedical education through internationalization at home	ERASMUS 2027
PIECES	101104390	Towards large-scale adaption and tailored implementation of evidence-based primary cancer prevention programmes in europe and beyond	HORIZON EUROPE
EARLY	101095392	Evaluating, Identifying and Reducing determinants of MHCs in Youth (EARLY)	HORIZON EUROPE

Aktualisht Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka në vazhdimësi 4 (katër) projekte ndërkombëtare, në të cilat UMT është partner.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në kuadër të strategjisë së tij të ndërkombëtarizimit, ka vënë në dispozicion kapacitetet akademike, administrative dhe infrastrukturore për të mundësuar bashkëpunime të frytshme me akademikë nga Diaspora.

Përgjatë periudhës Qershor-Dhjetor 2024 janë realizuar bashkëpunime në kuadër të aktivitetit mësimor si dhe kërkimor-shkencor ku akademikë që operojnë në Diasporë janë të përfshirë si staf i ftuar në projekte të READ -AADF.

Konkretisht nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë janë të angazhuar në projektet READ 4 staf akademik: Prof. Arsen Seferi, Prof. Albana Gjyzari, Prof. Suela Këllici, Prof. Entela Haloci. Ndërsa nga Diaspora janë të angazhuar 4 akademik.


### *7.3 Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+*

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë bashkëpunon me 25 universitete të huaja, në kuadër të programit Erasmus+ dhe shkëmbimit të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ.


Për vitin akademik 2023-2024, UMT ka realizuar shkëmbimin e studentëve dhe stafit në bashkëpunim me 18 institucione si më poshtë:

1. Universiteti i Saarlandit, Gjermani
2. Universiteti i Akuilës, Itali
3. Universiteti Ondokuz Mayıs, Turqi
4. Universiteti West Atika, Greqi
5. Universiteti i Mjekësisë Graz, Austri
6. Universiteti Lavoslav Ruzicka, Vukovar, Kroaci
7. Universiteti i Kamerino-s, Itali
8. Universiteti i Sevilës, Spanjë
9. Universiteti i Sofjes, Bullgari
10. Universiteti i Aristotle, Selanik, Greqi
11. Shkolla Verore Vascern, Paris, Francë
12. Kolegji i Kujdesit Shëndetësor, Talin, Estoni
13. Universiteti i Cote d'Azur, Nice, Francë
14. Universiteti i Mjekësisë, Wrocław, Poloni
15. Universiteti i Mjekësisë dhe Farmacisë, Kraiovë, Rumani
16. Universiteti i Granadës, Spanjë
17. Yuksek Ihtisas University in Ankara/Turkey
18. Pavol Jozef Šafárik University in Košice, Sllovaki

Shkëmbimi i stafit akademik, administrativ dhe studentëve të kryer përgjatë viteve 2022-2024, pasqyrohet në grafikët e mëposhtëm:



Grafiku 1 Staf i dhe studentë të dërguar



Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka realizuar shkëmbime studentore edhe në kuadër të programit CEEPUS. Gjatë vitit akademik 2023-2024, në kuadër të këtij programi, janë dërguar 6 studentë nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, si dhe është pritur një studente për kryerjen e mobilitetit në institucionin tonë.

#### 7.4 Anëtarësimi i UMT-së në rrjete ndërkombëtare

**Balkan Universities Association (BUA):** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar me të drejta të plota në Shoqatën e Universiteteve të Ballkanit (BUA). BUA është një rrjet universitar, që përbëhet nga 66 universitete anëtare dhe përfshin vendet e Ballkanit dhe Evropës Lindore. Ky rrjet është krijuar për të mundësuar lidhje të ngushta mes universiteteve të Ballkanit në ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit, shkëmbimin studentor dhe të personelit akademik, si dhe në punimet e përbashkëta shkencore.

**Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF):** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar i këtij rrjeti në cilësinë e anëtarit vëzhgues. Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF), e krijuar 50 vite më parë, bashkon mbi 800 universitete nga më shumë se 100 vende të botës, rrjete universitare, qendra kërkimore-shkencore dhe përfaqëson një nga agjencitë më të mëdha të institucioneve të arsimit të lartë në botë.

**UNIADRION:** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtarësuar në UNIADRION, që

përfaqëson një shoqatë universitetesh dhe qendrash kërkimore të zonës adriatiko-joniane, themeluar në vitin 2000. Qëllimi i UNIADRION-it është bashkëpunimi midis universiteteve dhe qendrave kërkimore, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe favorizimin e përparimit të kulturës, shkencës, trajnimit dhe kërkimit në vendet e zonës adriatiko-joniane.

## 7.5 Aktivitete të edukimit të vazhdim<sup>20</sup>

Qendra e Zhvillimit Profesional është njësi që ka si qëllim parësor ofrimin e edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë të certifikuar. UMT ka krijuar një numër të madh modulesh të formimit të vazhduar në funksion të përditësimit të kualifikimit profesional të vazhdueshëm të tyre si dhe freskim dhe thellim të njohurive përkatëse, të cilat hartohen dhe organizohen në nivel fakulteti/departamenti/shërbimi. Këto module janë të organizuara në formën e konferencave/seminareve/leksioneve të hapura, ku të interesuarit marrin kreditet përkatëse, certifikohen nga UMT. UMT ka kaluar në mënyrë të suksesshme auditet e bëra në QZHP, duke fituar si i vetmi institucion arsimor publik në vend, statusin e ofruesit të akredituar pa limit.

Aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituar nga QZHP për vitin akademik 2023-2024, me gjithësej 262.5 kredite, paraqiten si më poshtë vijon:

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i aktivitetit</b>	<b>Data e aktivitetit</b>
1	Parandalimi dhe shëndeti i njeriut	26 Tetor 2023
2	Testet Laboratorike ne Gjinekologji	28 Tetor 2023
3	Konferenca Ndërkombëtare mbi Komunikimin e Rrezikut, Përfshirjen e Komunitetit dhe Menaxhimin Infodemik për Infeksionet dhe Sëmundjet Kronike në Situatat Shëndetësore Emergjente	26-27 Tetor 2023
4	Konferenca Kombëtare e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë 2023	3-4 Nëntor 2023
5	PAAO 2023, Konferenca e Okulistikës	3-4 Nëntor 2023
6	Sfidat e echinococcosis ne ditet e sotme	2 Dhjetor 2023
7	Përditësimi në menaxhimin e patologjive të ndryshme, diskutim interdisiplinar	5-7-12 Dhjetor 2023
8	Update në Neurokirurgjinë pediatrike	1 Dhjetor 2023
9	Toraksi dhe Respiracioni	7 Dhjetor 2023
10	Konferenca Vjetore e Sëmundjeve Infektive 2023	2 Dhjetor 2023
11	Kirurgjia Neonatale Miniinvazive	23-24 Nëntor 2023
12	Diabeti-Obeziteti dhe ndërlikimet kronike, Përditësime 2023	15-16 Dhjetor 2023
13	Insuficiencia kardiake, Sëmundjet endokrinologjike dhe Hiperuricemia	9-10 Dhjetor 2023
14	Kujdesi multidisiplinar në këndvështrimin e risive të reja në infermieri	18-19 Janar 2024
15	Konferenca vjetore DRSHIKIOGJ, Perspektiva dhe Aktualitete	26 Janar 2024

<sup>20</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtorja e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektorati i UMT

16	Përditësim në menaxhimin e patologjive të ndryshme, diskutim interdisiplinar	22, 28 Shkurt 2024 dhe 9, 24 Prill 2024
17	Teknika e Mohs-it	26-27 Shkurt 2024
18	Akademia e Onkologjisë- Trajnim 1	13 Mars 2024
19	Akademia e Dializës Peritoneale	28 Mars 2024
20	Shëndet i veshkave për të gjithë	12-13 Prill 2024
21	Inteligjenca artificiale dhe roli i saj në mbështetje të mjekësisë diagnostikuese	11 Maj 2024
22	Qasje e integruar në disfunktionet seksuale dhe infertilitetin mashkullor	17 Maj 2024
23	Akademia e Onkologjisë- Trajnimi II	29 Maj 2024
24	Konferenca Kombëtare e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë- Pranverë 2024	25-26 Maj 2024
25	Triazhi dhe aplikimi i tij në Departamentin e Urgjencës	20 Qershor 2024 28 Qershor 2024 5 Korrik 2024 19 Korrik 2024 30 Korrik 2024
26	Kongresi internacional i specializanteve të kirurgjise orale dhe maksilofaciale	7-8-9 Qershor 2024
27	Akademia e transplantit renal	14 Qershor 2024
28	Mjekësia laboratorike në mbështetje të menaxhimit të sëmundjeve infektive	22 Qershor 2024
29	Mjekësia interne nga laboratorit në klinikë: Fuqia e qëllimit të përbashkët	16 Korrik 2024
30	Trajtimi i faktorëve të riskut kardiovaskular në pacientët me diabet	24- 27 Qershor 2024 dhe 4 Korrik 2024
31	Sindroma Kardio Renale Metabolike. Perditesime 2024	28-29 Qershor 2024
32	Cdo frymemarrje vlen	26 Shtator 2024
33	Mjekësia interne nga laboratorit në klinikë: Fuqia e qëllimit të përbashkët	11 Tetor 2024
34	Tirana microneurosurgery hand-on course	27-28 Tetor 2024
35	Konferenca kombëtare vjetore e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë 2024	25-26 Tetor 2024
36	Kompleksiteti i dhimbjes në 360	14 Nëntor 2024
37	Edukimi në vazhdim në Pediatri. Përditësimet e reja për një kujdes optimal ndaj fëmijëve	4 Dhjetor 2024

## VIII. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK

## 8.1 Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet

Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, zhvillojnë aktivitetin akademik dhe procesin mësimor në godinat si më poshtë:

1. Godina Qendrore
2. Godina e Lëndëve Paraklinike
3. Godina e Anatomisë
4. Godina e Mjekut të Familjes
5. Godina Galileo Galilei
6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik\*
7. Godina nr. 1 e Shkencave Mjekësore Teknike
8. Godina nr. 2 e Shkencave Mjekësore Teknike
9. Godina e Mjekësisë Dentare

Theksojmë faktin se vendndodhja e godinave në funksion të veprimtarisë akademike, kërkimore e shkencore është në kampuse universitare spitalore (përveç Godinës Qendrore dhe Godinës së Farmacisë dhe Shëndetit Publik), lehtësisht të arritshme nga studentët nëpërmjet transportit publik për në spitalet universitare.

UMT-ja, referuar aseteve infrastrukturore në pronësi të saj, me një sipërfaqe rreth 17,000m<sup>2</sup> (nga të cilat 12,000m<sup>2</sup> në funksion të procesit mësimor dhe 5,000m<sup>2</sup> në funksion të veprimtarisë administrative), disponon auditorë, klasa, laboratorë, mjedise për personelin akademik, salla mbledhjeje, salla kompjuterësh etj., si më poshtë:

1. Godina Qendrore përfshin 2 auditorë, me kapacitet përkatësisht 60 dhe 100 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.
2. Godina e Lëndëve Paraklinike përfshin 3 auditorë leksionesh, me kapacitet 250 vende uljeje, 21 salla seminari me 30 vende uljeje, 13 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 31 zyra administrative.
3. Godina e Anatomisë përfshin 2 auditorë, me kapacitet 210 vende uljeje, 2 salla seminari me 30 vende uljeje, 5 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 9 zyra administrative.
4. Godina e Mjekut të Familjes përfshin 1 auditor, me kapacitet 150 vende uljeje, 2 salla seminari me 20 vende uljeje, si dhe 2 zyra administrative.
5. Godina Galileo Galilei përfshin 1 auditor, me kapacitet 150 vende uljeje, si dhe 3 zyra administrative.
6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik përfshin 1 auditor me kapacitet 100 vende uljeje, 5 salla seminari me 30 vende uljeje, 12 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 20 zyra administrative. *Kjo godinë pritet të jetë funksionale pasi pësoi dëme të konsiderueshme nga tërmeti i nëntorit 2019.\**
7. Godina nr. 1 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 6 auditorë, me kapacitet 330 vende uljeje, 10 salla seminari me 50 vende uljeje, 4 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.
8. Godina nr. 2 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 11 auditorë me kapacitet 780 vende uljeje, 14 salla seminari me 50 vende uljeje, 3 laboratorë me 70 vende uljeje, si dhe 21 zyra administrative.
9. Godina e Mjekësisë Dentare përfshin 2 auditorë, me kapacitet 200 vende uljeje, 3 salla seminari

me 60 vende uljeje, 15 laboratorë me 25 vende ulje, si dhe 14 zyra administrative.

10. Palestra sportive (shkolla "Skënder Çaçi") është në shërbim të studentëve dhe personelit.

11. Biblioteka/salla leximi, 4 ambiente, ku mundësohet edhe aksesimi në internet.

Në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor, investime të reja janë realizuar, si më poshtë:

- Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë ndërtuar 2 laboratorë modernë për infermieristikën, në partneritet me projektin HAP, në kuadër të hapjes së programit Master Profesional në "Infermieri familje".
- Në Fakultetin e Mjekësisë është ndërtuar laborator i biosimulimit klinik, me mbështetjen e Global Found, i vetmi në llojin e vet në vend. Ky laborator ka luajtur një rol të rëndësishme në trajnimin e personelit mjekësor gjatë pandemisë Covid 19.

Gjithashtu, në kuadër të Paktit për universitetin, është miratuar dhe pritet të fillojë zbatimi i projektit të Kampusit Multifunksional për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i cili do të mundësojë sigurimin me cilësi dhe në formë të përqendruar:

- të laboratorëve të biosimulimit teknik në funksion të procesit mësimdhënës për të gjitha programet e studimit që ofron UMT-ja,
- të qendrës së zhvillimit profesional
- infrastrukturën e nevojshme për testimin dhe vlerësimin e informatizuar si për studentët që regjistrohen për herë të parë, ashtu dhe për pranimet e specializantëve, testimet të pjeshme semestrale etj.
- të bibliotekës qendrore e UMT (sipas standardeve evropiane , ku përveç fondit të titujve të shërbeje dhe salla leximi),
- të sallës Aula Magna e Universitetit me kapacitete 300-350 vende ulje
- Zyra, kafeteri për studentet dhe tjerët, si dhe ambiente teknike shërbimit.

Pjesë integrale e UMT janë edhe qendrat spitalore universitare (rreth 130,000m<sup>2</sup>), si:

1. Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"<sup>21</sup>
2. Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni"<sup>22</sup>
3. Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë<sup>23</sup>
4. Spitali Universitar i Traumës, Tiranë<sup>24</sup>
5. Klinika Stomatologjike Universitare<sup>25</sup>
6. Pjesë e kampusit spitalor universitar bëhet edhe Spitali i Ri Qëndror në QSUT, i cili ka një sipërfaqe totale ndërtimi prej 23,290 m<sup>2</sup>.
  1. Instituti i Shëndetit Publik<sup>26</sup>
  2. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut<sup>27</sup>.

<sup>21</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/655/1b7da247-846f-475d-b7fc-fdd260fca8d2;q=vkm%20655%20date%2010.11.2017>

<sup>22</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/656/f77737b8-6c45-45cb-b812-fec9256bed64;q=vkm%20656%20date%2010.11.2017>

<sup>23</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/658/266dfd4c-0945-46d1-a8a2-0a38b3017762;q=vkm%20658%20date%2010.11.2017>

<sup>24</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/657/fcd95b30-773f-4acf-947c-fd5bb8bb7ab3;q=vkm%20657%20date%2010.11.2017>

<sup>25</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/03/66/ebf58427-d7c1-4f3a-ae32-426ddb24d7e8;q=vkm%2066%20date%2003.02.2017>

<sup>26</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/03/66/ebf58427-d7c1-4f3a-ae32-426ddb24d7e8;q=vkm%2066%20date%2003.02.2017>

<sup>27</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/03/66/ebf58427-d7c1-4f3a-ae32-426ddb24d7e8;q=vkm%2066%20date%2003.02.2017>

## IX. STUDENTËT

### 9.1 Regjistrimet në programet e studimit për vitin akademik 2023-2024

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ofron programe studimi ndër më të kërkuarat nga maturantët. Përzgjedhja e studentëve të rinj në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë është bërë mbi bazën e kriterëve të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së.

Procesi i përzgjedhjes së studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruara të ciklit të dytë, kryhet dhe administrohet nga komisioni përkatës, i ngritur në nivel institucioni, me përfaqësues të fakulteteve dhe të rektoratit.

Procesin e përzgjedhjes së studentëve që aplikojnë në kuotat e veçanta apo transferim studimesh, në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, e kanë menaxhuar vetë njësitë kryesore, ndërsa Rektori i UMT-së ka luajtur rolin e monitoruesit.

Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, në përputhje me kërkesat e njësive kryesore, Rektori i UMT-së ka miratuar rialokim të kuotave për programet e të njëjtit cikël studimi, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

Senati Akademik i UMT-së, për vitin akademik 2023-2024, ka miratuar në total 3141 kuota, për regjistrimet e reja të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për studentë dhe normativën për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student sipas kornizës ligjore në fuqi.

Kuota të miratuara me vendim të Senatit Akademik të UMT për vitin 2023-2024 janë si vijon:

<b>Njësia kryesore</b>	<b>Bsc.</b>	<b>MP.</b>	<b>Msc.</b>	<b>PICD</b>	<b>SPA</b>	<b>Dr.</b>	<b>Total i</b>
Fakulteti i Mjekësisë	40	55	25	599	262	199	1180
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	133	-	-	162	10	19	324
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	915	395	315	-	-	12	1637
<b>TOTALI</b>	<b>1088</b>	<b>450</b>	<b>340</b>	<b>761</b>	<b>272</b>	<b>230</b>	<b>3141</b>

Nga të gjithë kuotat e miratuara, shkalla e realizimit të tyre ka qenë si më poshtë:

<i>Numri i kuotave të realizuara për vitin akademik 2023-2024</i>							
<b>Njësia kryesore</b>	<b>Bsc.</b>	<b>MP.</b>	<b>Msc.</b>	<b>PICD</b>	<b>SPA</b>	<b>Dr.</b>	<b>Totali</b>
Fakulteti i Mjekësisë	22	34	15	581	221	173	1046
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	86	-	-	155	7	19	267
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	830	107	255	-	-	12	1204
<b>TOTALI</b>	<b>938</b>	<b>141</b>	<b>270</b>	<b>736</b>	<b>228</b>	<b>204</b>	<b>2517</b>

Shkalla relativisht e ulët e realizimit të kuotave të miratuara për programet e ciklit të dytë, veçanërisht në programet “Master Profesional”, është e shpjegueshme me faktin se një numër i

konsiderueshëm studentësh që përfundojnë studimet e ciklit të parë, kryesisht në shkencat mjekësore teknike, zgjedhin të punësohen. Ky është një tregues se formimi që ata marrin në studimet e ciklit të parë Bachelor, i bën ata të aftë dhe konkurrues për tregun e punës, brenda dhe jashtë vendit.

UMT-ja, për vitin akademik 2023-2024, ka pasur në total, rreth **7413** studentë në programet e studimit të të gjitha cikleve. Shpërndarja e studentëve sipas cikleve të studimit, paraqitet si në tabelën më poshtë:

	Bsc	MP	Msc	PICD	SPA	Dr	Totali
Fakulteti i Mjekësisë	67	34	33	2654	761	173	<b>3722</b>
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	314	-	-	595	32	19	<b>960</b>
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	2140	105	474	-	-	12	<b>2731</b>
<b>TOTAL</b>	<b>2521</b>	<b>139</b>	<b>507</b>	<b>3249</b>	<b>793</b>	<b>204</b>	<b>7413</b>

Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të integruar të ciklit të dytë janë kryer bazuar në Udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin nr. 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”.

Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë (SPA) janë kryer duke u bazuar në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në UMT, e ndryshuar, Vendimin Qarkullues nr.35, datë 25.03.2024 “Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, të ndryshuar, të Senatit Akademik të UMT, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 25.03.2024 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2023-2024”, të ndryshuar, të Rektorit të UMT-së.

## 9.2 Mbështetja ndaj studentëve

Në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UMT-së, si dhe legjislacionit në fuqi, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, mbështet studentët në nivel universiteti dhe kryesisht në nivel fakulteti. Kjo mbështetje i është dhënë si nga ana infrastrukturore dhe financiare, pjesëmarrje në projekte Erasmus, ashtu dhe nëpërmjet mbështetjes së pedagogëve lidhur me aktivitet shkencore, në konkurse etj.

Përveç mbështetjes së studentëve nëpërmjet ofrimit të infrastrukturave bashkëkohore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë zbaton rregullisht një politikë të mbështetjes financiare të studentëve, të kategorive të veçanta, si:

- Komuniteti Ballkano-Egjiptian
- Studentë me aftësi ndryshe;
- Studentë me prindër invalid, jetim, etj;

Një vëmendje të veçantë, UMT ia kushton studentëve me arritje të larta akademike, atyre me ndihme

ekonomike apo me aftësi të kufizuara (cikli I dhe II) duke i mbështetur ata me bursa, përjashtim nga tarifa e shkollimit apo përgjysmim të saj.

Në total përfitojnë bursë rreth 34%<sup>28</sup> e studentëve të ciklit të parë dhe ciklit të dytë në UMT (6416) nga të cilët:

- 68% studentë për arritje akademike;
- 29% me ndihmë ekonomike;
- 3% studentë me pagë minimale sipas VKM nr.386, datë 1.6.2022

### 9.3 Aktivitetet sportive në UMT<sup>29</sup>

U  
niversiteti i Mjekësisë, Tiranë që nga viti 2018 ka ngritur Shoqatën e Sportit të UMT me qëllim:

- promovimin e sportit, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve sportive që do të realizohen me mbështetjen edhe të institucioneve të tjera vendore/lokale dhe qendrore.
- organizimin e veprimtarive sportive, në rang lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- organizimin e skuadrave (ekipe) sportive në disiplina të ndryshme sportive;
- zhvillimin e sportit universitar në të gjitha nivelet sportive;
- promovimin e të gjitha rezultateve të arritura nga studentët në disiplina të ndryshme sportive;
- organizimin e kampeve, seminareve, trajnimeve, publikimeve profesionale, etj., konform dispozitave ligjore, me qëllim avancimin e sportit.
- nxitjen e zhvillimit të sportit në rang universitetesh në nivel dhe sigurimi i pjesëmarrjes së shoqatës në gara dhe turne ndërkombëtare.

Gjithashtu, pranë Rektoratit të UMT-së, specialisti i sportit bashkëpunon ngushtë me shoqatën sportive si dhe me strukturat e tjera të njëjësive kryesore për aktivizimin e studentëve të viteve të ndryshme në pjesëmarrje në aktivitete sportive të cilat organizohen në rang universiteti/lokal apo dhe nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar.

Aktivitetet sportive të realizuara gjatë vitit akademik 2023-2024 me studentët e UMT gjenden në foto galeri “Aktivitetet Sportive 2023-2024\_UMT”

---

<sup>28</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtoria Ekonomike, Rektorati i UMT-së

<sup>29</sup> Informacioni është dhënë nga Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, Rektorati i UMT-së

# X. ANALIZA FINANCIARE 2024

## Raporti Financiar për vitin akademik 2023-2024

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së UMT-së, ushtron funksionet e tij akademike dhe administrative nëpërmjet Administratës së UMT-së dhe tre Njësiave Kryesore (Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare).

Gjatë këtij viti janë realizuar objektivat për të përmbushur kërkesat ekonomike dhe financiare në funksion të realizimit të misionit të UMT-së. Realizimi i shpenzimeve për çdo program përfshin shpenzimet në fushën e pagave, shpenzimet materiale dhe të mirëmbajtjes, shpenzime të tjera të nevojshme për funksionimin e procesit akademik dhe punën kërkimore-shkencore. Shpenzimet për investimet me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e veprimtarisë akademike, krijimin e laboratorëve të rinj, si dhe nxitjen e punës kërkimore shkencore etj.

Ky raport pasqyron shpenzimet e realizuara pranë Degës së Thesarit deri në përfundim të vitit 2024, ndërkohë që është punuar intensivisht në realizimin e buxhetit vjetor të UMT-së dhe një pjesë e konsiderueshme e procedurave të prokurimit, të cilat janë finalizuar në fund të vitit 2024 dhe efektin financiar do ta reflektojnë në vitin 2025.

Këto procedura janë:

- Rikonstruksion i godines së Famacisë dhe Shëndetit Publik;
- Mbikqyrja për rikonstruksion i godinës së Famacisë dhe Shëndetit Publik;
- Rikonstruksion i godinave të FSHMT (Heqje dhe furnizim-vendosje dyer dhe dritare);
- Blerje Karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Blerje materiale kancelarie për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Blerje siguracioni për sigurimin e shëndetit të studentit specializant të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Blerje siguracioni për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të studentit specializant të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Blerje tonera për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Furnizim dhe vendosje kondicionere për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Kolaudim për rikonstruksion e Ambienteve të Arkivës, njësia qendrore Rektorat;
- Blerje paisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabinetet mesimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Shërbim analizash për realizim e projektit “*Identifikimi i faktorëve tradicionalë dhe jotradicionalë të rrezikut kardiovaskular në Sëmundjen Renale Kronike*”;
- Blerje kontenerë dhe marrje e shërbimit të analizave për realizimin e projektit “*Konsumi mesatar ditor i kripës në popullatën e Republikës të Shqipërisë*”;
- Shpenzime për faqosjen e artikujve, përgatitjen për botim dhe publikimi i tyre në faqen e internetit.
- Mbikqyrje dhe rikonstruksion i Ambienteve të Arkivës, njësia qendrore Rektorat.

Formatet e tabelave të përdorura në këtë raport janë në përputhje me tabelat e dërguara nga AKFAL mbi formën dhe mënyrën e raportimit të raportit vjetor të IAL-ve, përcjellë me shkresë nr.75/5 datë 31.07.2023.

### **Treguesit ekonomik - financiarë**

- **Plani Buxhetor Afatmesëm (PBA)**

Hartimi i treguesve të PBA 2024-2026 dhe rishikimet e treguesve gjatë hartimit të PBA 2025-2027, janë bërë në përputhje me kuadrin parashikues të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2021-2030), plotësimin e rekomandimeve të Raportit të Akreditimit Institucional, si dhe në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuar për realizimin e politikave dhe misionit të UMT-së.

Hartimi i PBA-së është ndërtuar bazuar në metodologjinë bazë të planifikimit, ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitin 2024, strukturën organizative të institucionit, ndryshimet e pritshme në programet e studimit, numrit të studentëve, nivelin e parashikuar të financimit nga Buxheti i Shtetit si dhe kërkesat për shpenzime e investime të paraqitura nga njësitë bazë të UMT-së.

- **Burimet e Financimit**

Financimi i aktivitetit të UMT-së, sipas përcaktimeve në ligjin për arsimin e lartë, realizohet nëpërmjet:

1. Buxhetit të shtetit, i cili shpërndahet në formë granti buxhetor i përbërë nga:
  - a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
  - b) granti i mësimdhënies, i detajuar për pagat dhe sigurime shoqërore, shpenzime materiale dhe shërbime, bursat e studentëve (*Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit*);
  - c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese.
2. Të ardhurat e kushtëzuara të institucionit (*për funksionim dhe investime*)
3. Burime të tjera të ligjshme (*donacione, projekte*)

- **Parashikimi i të ardhurave**

Në parashikimin e krijimit të të ardhurave është mbajtur parasysh realizimi i të ardhurave në vitet e kaluara, numri i programeve të studimit, numri i studentëve aktualë, kuotat e reja (shitesë) për vitin akademik 2023-2024, tarifat aktuale të pagesës së shkollimit sipas viteve si dhe burime të tjera që janë të ardhurat nga tarifat e regjistrimit etj.

→ *Parashikimi i të ardhurave të pritshme sipas burimeve të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:* (në mijë lek)

<b>Të dhëna për planin Buxhetor Afatmesëm</b>			
<b>Grante nga Buxheti i Shtetit</b>			
<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Viti 2023</b>	<b>Viti i Pritshëm 2024</b>	<b>Viti Parashikim</b>
Granti për Mësimdhënien	1,064,736	1,339,561	1,276,613
Granti AKFAL/Mareveshja tripalëshe	16,660	21,298	22,320
Granti për Punën Kërkimore-shkencore	15,685	17,568	11,128
Granti për Projektet e Zhvillimit	50,657	109,693	3,816
Granti per ndertesat demtuar termeti			
<b>Totali</b>	<b>1,147,737</b>	<b>1,488,119</b>	<b>1,313,877</b>
<b>Disbursime të projekteve të huaja</b>			
<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Viti Paraardhës</b>	<b>Viti Aktual</b>	<b>Viti Pasardhës</b>
Disbursime të projekteve te huaja	20,803	10,407	15,024
<b>Totali</b>	<b>20,803</b>	<b>10,407</b>	<b>15,024</b>
<b>Të ardhurat e institucionit (transferta e pakushtëzuar)</b>			
<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Viti Paraardhës</b>	<b>Viti Aktual</b>	<b>Viti Pasardhës</b>
Qera	96		
Profesionale 2-vjeçare			
Tarifa shkollimi	206,871	263,749	512,261
Libreza Diploma etj.	768	630	830
Lëshim dokumenti	6,569	6,114	6,208
Taksë regjstrimi	8,303	8,990	8,305
Tarifa konkurrimi	667	400	400
Tjera - shërbime	153	13	
Sponsorizime	21		
<b>Totali</b>	<b>223,448</b>	<b>279,896</b>	<b>528,004</b>

Të ardhurat për tarifën e shkollimit për vitin pasardhës në tabelën e mësipërme janë paraqitur me tarifa te plota si paraqiten ne formatin e PBA-së, pa aplikuar reduktimin e tarifave të shkollimit sipas VKM-ve përkatëse

• **Parashikimi i shpenzimeve**

Në parashikimin e shpenzimeve të PBA 2024-2026, të rishikuara gjatë hartimit të PBA 2025-2027 është mbajtur parasysh parashikimi i nevojave për paga dhe sigurime shoqërore për numrin e punonjësve të miratuar të institucionit, ndryshimet si efekt i rritjes së nivelit të pagave, plotësimi sa më i mirë i nevojave me bazë materiale, investime, kërkim shkencor etj., me qëllim sigurimin e zhvillimit normal të aktivitetit të UMT-së.

→ *Parashikimi i shpenzimeve të pritshme sipas llogarive buxhetore paraqitet në tabelën e mëposhtme (në mijë lek)*

<b>Të dhëna për planin Buxhetor Afatmesëm</b>			
<b>Shpenzime</b>			
<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Viti Paraardhës</b>	<b>Viti Aktual</b>	<b>Viti Pasardhës</b>
Paga e shperblime	815,648	1,085,837	1,085,837
Sigurime Shoqërore e shëndetësore	118,337	171,053	171,053
Shpenzime operative	111,980	225,355	181,235
Transferta të brendshme			
Transferta me jashtë	560	400	600
Transferta për individët	2,634	250	250
Bursa	177,659	197,290	219,600
Bursa/AKFAL-Marreveshje tripaleshe	15,561	21,298	22,320
Kërkimi shkencor	33,196	57,579	15,185
Investime	2,971	509,229	100,978
Projekte të huaja	0	19,270	12,201
<b>Totali</b>	<b>1,278,545</b>	<b>2,287,561</b>	<b>1,809,260</b>

Në përcaktimin e shpenzimeve sidomos materiale, shërbime dhe investime, parashikimi është shoqëruar me një proces të mbledhjes së kërkesave nga të gjithë departamentet, shërbimet dhe njësitë.

Në këtë program buxhetor afatmesëm, financimi i shpenzimeve të projekteve për investime është parashikuar të kryhen nga të ardhurat që krijojnë njësitë shpenzuese të UMT-së.

## Plani buxhetor njëvjeçar për vitin 2024

- **Plani buxhetor njëvjeçar për të ardhurat**

Në planin buxhetor njëvjeçar për të ardhurat, si burim financimi janë planifikuar financimi nga buxheti i shtetit në formë granti (i cili përbëhet nga grant i politikave të zhvillimit, granti i mësimdhënies, kërkimor-shkencor, të ardhurat e institucionit (transferta e pakushtëzuar) dhe disbursime nga projektet me financim të huaj.

→ *Plani buxhetor njëvjeçar për të ardhurat paraqitet në tabelën e mëposhtme:*

*(në mijë lek)*

Nr	Emërtimi i Projektit	Plani buxhetor njëvjeçar i të ardhurave 000/lekë			Pesha spec në%
		Mbartur nga viti paraardhës	Financimi i vitit aktual	Buxheti vitit	
<b>1</b>	<b>Financimi nga Buxheti i Shtetit</b>	<b>99,864</b>	<b>1,174,633</b>	<b>1,274,497</b>	<b>52.1%</b>
1.1	Granti mësimdhënies	75,421	831,717	907,138	37.1%
1.2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	150	228,060	228,210	9.3%
1.3	Granti Konkurrues/09450	12,794	68,790	81,584	3.3%
1.4	Granti Kërkimit shkencor/09770	11,499	46,066	57,564	2.4%
	<i>Mbeshetje financiare Marreveshje tripalëshe/09770</i>	<i>1,099</i>	<i>26,076</i>	<i>27,175</i>	<i>1.1%</i>
	<i>REKTORAT</i>	<i>0</i>	<i>3,840</i>	<i>3,840</i>	<i>0.2%</i>
	FM	1,041	20,076	21,117	0.9%
	FMD	58	2,160	2,218	0.1%
	<i>Projekte-Kërkimit shkencor/09770</i>	<i>10,400</i>	<i>19,990</i>	<i>30,389</i>	<i>1.2%</i>
1.5	TVSH- Projekte të huaja	0		0	0.0%
	Disbursime				
<b>2</b>	<b>Disbursimet nga projektet me financim të huaj</b>	<b>16,711</b>	<b>8,616</b>	<b>25,327</b>	<b>1.0%</b>
<b>3</b>	<b>Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar</b>	<b>890,396</b>	<b>256,822</b>	<b>1,147,219</b>	<b>46.9%</b>
	<b>TOTALII TË ARDHURAVE</b>	<b>1,006,972</b>	<b>1,440,071</b>	<b>2,447,042</b>	<b>100.0%</b>

Siç shihet në tabelën e mësipërme plani me burim financimi si nga granti dhe nga të ardhurat është pothuajse i barabartë.

**Financimi nga buxheti i shtetit**, për grant mësimdhënie, bursa, mbeshetje financiare sipas marrëveshjeve tripalëshe, grant për kërkimin shkencor, zënë 52.1% të totalit të të ardhurave (burimeve financiare ne dispozicion). Nga këto, granti për mësimdhënie zë 37.1% të totalit të të ardhurave, granti për bursat e studentëve zë 9.3% të totalit të të ardhurave, bursa/mbeshetje financiare sipas marrëveshjeve tripalëshe zënë 1.1% të totalit të të ardhurave, granti për kërkim shkencor zë 2.4% të totalit të të ardhurave, granti për projekte të kërkimit shkencor 1.2% të totalit të të ardhurave etj.

**Financimi nga të ardhurat e institucionit-transferta e pakushtëzuar** zë rreth 46.9 % të totalit të të ardhurave.

Në planifikimin e të ardhurave të pakushtëzuara të institucionit janë mbajtur parasysh: realizimi i të ardhurave në vitet e kaluara, numri i programeve të studimit, numri i studentëve aktualë, kuotat e reja (shtesë) për vitin akademik 2023-2024, tarifat aktuale të pagesës së shkollimit sipas viteve, si dhe të ardhurat nga tarifat e regjistrimit etj.

**Të ardhurat e tjera** që UMT siguron nga vërtetimet, programet etj., për vitet në vazhdim janë parashikuar në vlera minimale, për arsye se me Vendimin e përbashkët nr.72, datë 14.12.2018 “Mbi kërkesat e këshillave studentore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, këto tarifa janë hequr për studentët gjatë viteve të studimit. Realizimi faktik i të ardhurave pa përfshirë transfertat e brendshme për transfertat brenda sistemit të UMT-së (nga njesitë e UMT-së në Rektorat e midis njesive), paraqiten në tabelën e mëposhtme:

(në mijë lek)

Përshkrimi (sipas kombinimit të strukturës kontabël)	UMT	
	Plan	Fakt
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>1,566,616</b>	<b>1,539,935</b>
Të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për të gjitha ciklet e studimit;	266,922	237,755
Të ardhura nga tarifa e regjistrimit	6,490	8,829
Të ardhurat nga konkurset e pranimit;	0	470
Të ardhura nga qiratë;	0	0
Të ardhurat nga shërbimet e ndryshme të IAL-së, etj	6,805	9,768
Të ardhura nga donacione, sponsorizime;	0	
